

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7473 E hënë 19 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Data 20 mars është caktuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), që nga viti 2013, si Dita Botërore e Lumturisë. Aktivitete për këtë ditë promovohen nga OKB... *Vijon në faqen 20*

Nga FATOS ÇOÇOLI

Rrëshqitja e palumturisë



Botimi

Ditës

Diplomati, studiuesi dhe analisti diplomatik i mirënjohur. Shaban Murati sapo ka nxjerrë nga shtypi librin e tij të ri "Çështja e paqenë e detit: Një intrigë..." *Vijon në faqen 21*

Shaban Murati: Enigmat dhe përgjigjet për çështjen e detin



Gjatë qëndrimit, ata u shoqëruan nga Petrit Sinani

Vizita e Rexhep Qosjes në Tiranë, Hadri: Nuk ka të drejtë, mirë ia bëtë, t'i ulet pak hunda

Raporti sekret i vitit 1974 për Ramiz Alinë, lidhur me vizitën në Shqipëri të profesorëve nga Kosova

Nga DASHNOR KALOÇI

A shtu siç kemi parë edhe në disa nga kapitujt e tjerë paraardhës të këtij libri, në fillimin e viteve '70-të, Shqipërinë e vizituan shumë personalitete të arsimit, kulturës dhe letrave shqipe, gjë e cila bëhej në kuadrin e një protokollit të përbashkët që kishte nënshkruar...

Në faqet 10-11

ARRESTIMI I KRYEBASHKIAKUT TE LEZHES, MBESHTETESIT: ESHTË SULM POLITIK

FRROKAJ, SOT PARA GJYQIT. PROTESTA NE POLICI: LIROJENI

Akuzat për abuzim me pronat në Shëngjin, Edi Paloka: Rama mezi pret të kapet diku për të na barazuar ne me 'Rilindjen' për qëndrimin ndaj drejtësisë



(Në foto) Kreu i Bashkisë së Lezhës, Fran Frrokaj. Qytetarët duke protestuar para policisë në Lezhë



GATI LISTA ME DELEGATE

Kuvendi i PD-së, grupi i punës takohet me kritikët e Bashës, mbledhja më 25 mars

Në faqen 5

INTERVISTA

Meta: Marrëveshja për detin të mos kalojë "vijat e kuqe", mendje e hapur për çështjen çame

Në faqen 2

ZBARDHET SKEMA

Trafikuan shqiptarë në SHBA, Kanada dhe Britani, ja e shkvara dhe bizneset që kanë

Në faqen 6

RIFRESKIMI

ATP: Dosjet e vitit 1996, pronarët që kompensohen dhe lista me 4900 vetë

Në faqen 18

KREU I SHOQATES: JEMI DHUNUAR GJATE PUNES



Elson Jaçaj: Portali për infermierët, dështim i hapur, ja pse ikin nga Shqipëria

Në faqet 8-9

Mjeku obstetër-gjinekolog: Farmacistë të papërgjegjshëm i japin pa rekomandim

Bajram Balliu: Ilaçet për abort, të palicencuara në Shqipëri

Ylli Merja: Propolisi i bletës, antibiotik i çmuar i natyrës

Nga VOLTIZA DURO

A borti është procesi që kryhet për ndërprerjen e shtatzanisë para moshës së barrës prej 22 javësh. Në vendin tonë, sipas statistikave kryhen deri në 17.2 aborte për 100 lindje. Në një intervistë për suplementin "Life Pages"



në "Gazeta Shqiptare", mjeku obstetër-gjinekolog Bajram Balliu tregon se medikamentet që merren për ndërprerjen e shtatzanisë jepen nga shumë farmacistë të papërgjegjshëm pa këshillën e mjekut. Sipas mjekut, këto...

Suplement

PAKTI DETAR INTERVISTA

Presidenti flet për "Paktin", "Shqipërinë e madhe" dhe përgjigja për Bushatin

Në nga marrëveshjet më të rëndësishme, për të cilat po negociojnë muajt e fundit Athina dhe Tirana në kuadrin e një dialogu të gjerë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe të trashëguara prej historisë është delimitimi i zonave detare. Këtë thekson midis të tjerash, në intervistën e tij për gazetën "To Vima" të së dielës, presidenti Ilir Meta. I pyetur se përse nuk i ka dhënë ministrit të Jashtëm "dritën jeshile" për përfundimin e negociatave me Greqinë, Meta përgjigjet se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2010, përveçse konsideron marrëveshjen e vjetër antikushtetuese, përshkruan një hartë rruge që përcakton qartë hapat institucionale të procesit dhe metodologjinë që mund të përdoret, e se ai në pozitën e presidentit nuk mund të të kalojë këto "vijat e kuqe".

Z. president, Shqipëria kërkon një datë për nisjen e negociatave për hyrjen në Bashkimin Europian në qershor. A keni shpresë se data do të njoftohet, veçanërisht pas raportit të fundit të Komisionit Europian mbi Strategjinë për Ballkanin Perëndimor?

Ambicia e madhe e Shqipërisë është anëtarësimi i plotë në Bashkimin Europian. Ky projekt strategjik gëzon mbështetjen e qytetarëve shqiptarë dhe të politikës. Të gjithë aktorët institucionale dhe politikë kanë mbështetur në mënyrë unanime kërkesën e Shqipërisë për hapjen e negociatave sa më shpejt të jetë e mundur, gjë që unë e konsideroj si shenjë të pjekurisë politike dhe përgjegjësisë së vendit. Nuk është sekret që ne presim një vendim pozitiv për hapjen e negociatave, mundësisht gjatë presidencës bullgare të BE-së. Gjithashtu, jemi të ndërgjegjshëm se ky do të ishte një prolog për sfida më të mëdha dhe procese që duhet të ndryshojnë rrethësisht vendin.

Nga ana tjetër, strategjia e Komisionit Europian, e ndjekur nga turi i presidentit Juncker në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, është një shenjë e qartë e përkushtimit ndaj rajonit. Kam shpresë se Bashkimi Europian do të vazhdojë me këtë përkushtim për të përmbyshur premtime për anëtarësim të plotë dhe të ndihmojë të gjitha vendet në rrugëtimin e tyre.

Pavarësisht disa reformave të përmbyllura, rruga drejt integritimit në BE nuk është ende e qartë. Sipas burimeve të sigurta, korrupsioni mbetet problem, reforma në sistemin e drejtësisë është ende pezuar.

Meta: Marrëveshja për defin të mos kalojë "vijat e kuqe"

"Çështja çame të diskutohet me mendje të hapur"



Il dhe shumë analistë e përshkruajnë Shqipërinë si "Kolumbia e Europës" për shkak të prodhimit të marivuanës. Si u përgjigjeni këtyre?

Strategjia e re është shumë realiste kur thotë se Ballkani Perëndimor është larg të qenit gati për anëtarësim të plotë në BE. Reformë e thellë dhe e plotë në sistemin e drejtësisë, luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë luftën kundër kultivimit të drogës dhe trafikimit, janë sfidat kryesore ku duhen përqendruar përpjekjet. Kam besim se ky trend mund të ndryshojë me sukses, me vullnet të madh politik dhe ndihmë nga partnerët tanë. Padyshim që mundemi dhe duhet të bëjmë më shumë në këtë aspekt, veçanërisht në luftën ndaj krimit të organizuar, që është një kërcënim serioz për sigurinë dhe që nuk mund të mbahet brenda kufijve. Duhet të fitojmë këtë luftë për t'u vërtetuar qyteta-

rë tanë që policia është më efiçente dhe bashkëpunuese sesa rrjetet e krimit.

Disa analistë shprehin shqetësime serioze se Tirana po kërkon ende të përmbyshë vizionin e "Shqipërisë së Madhe". Ata paralajmërojnë se kjo mund të krijojë paqëndrueshmëri në Ballkan. Kohët e fundit, kryeministri Edi Rama tha se Shqipëria dhe Kosova duhet të kenë një president të përbashkët në të ardhmen. Si mendoni?

Më lejoni që t'ju korrigjoj, Tirana nuk ka kërkuar kurrë dhe nuk do të kërkojë të përmbyshë legjendën urbane të "Shqipërisë së Madhe". Si president e kam bërë të qartë gjithmonë se Shqipëria është një partner i besueshëm në rajon. Që kur u rrezua diktatura komuniste, projektet më ambicioze të vendit tonë kanë qenë NATO-ja dhe BE-ja. Kemi investuar të gjitha burimet politike, institucionale dhe njerëzore për këtë

MARRËVESHJA

Presidenti Meta deklaroi se marrëveshja për kufirin detar me Greqinë duket të ketë si "vijë të kuqe" respektimin e Kushtetutës. "Është e rëndësishme të kemi një marrëveshje perfekte nga ana ligjore, praktikisht të zbatueshme dhe përfundimisht të pavarueshme", tha Meta për të përjavshmen greke "To Vima".

qëllim. Politika jonë e jashtëme ka qenë gjithmonë e bazuar në paqe, stabilitet, siguri dhe fqinjësi të mirë me të gjitha vendet e rajonit. Për sa i përket Kosovës, dua të theksoj se në dekadën e parë të pavarësisë, ajo ka vërtetuar se nuk është kërcënim për paqen, stabilitetin apo sigurinë e ndonjë vendi tjetër të rajonit. Autoritetet më të larta të Kosovës kanë nisur një proces dialogu me Serbinë, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Europian dhe të asistuar nga Amerika, duke treguar se janë partnerë të besueshëm që përfaqësojnë interesat më të mira të vendit dhe qytetarëve të tyre. Tirana ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë këtë dialog, që ka për qëllim normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes dy vendeve. Sigurisht që Shqipëria ka arsye për të pasur marrëdhënie të shkëlqyera dypalëshe me Kosovën dhe përpjekjet tona reciproke kanë këtë qëllim. Për të njëjtat arsye, ne kërkojmë të kemi të njëjtin nivel mirëkuptimi dhe bashkëpunimi me të gjithë fqinjët dhe vendet e tjera të rajonit, sepse është në interesin tonë.

Muajt e fundit, Athina dhe Tirana kanë nisur një dialog të gjerë për të zgjidhur çështjet dypalëshe në një marrëveshje-paketë. Një nga çështjet më të ndjeshme ka të bëjë me detin, një marrëveshje e nënshkruar nga të dyja vendet në vitin 2009, por e gjykuar jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë. Kohët e fundit ju refuzuat t'i jepnit ministrit të Jashtëm, Ditmir Bushati, autorizimin për të vazhduar negociatat për një marrëveshje të re me homologun e tij, Nikos Kotzias. Pse e

bëtë këtë?

E para, kam nënvizuar gjithmonë faktin se marrëdhëniet e Shqipërisë me Greqinë janë të një rëndësie të madhe strategjike. Kam dashur gjithmonë që të shikoj një dialog të hapur për të diskutuar të gjitha çështjet me interes. Axhenda aktuale nuk vjen nga një plan et tjetër, as nuk është e imponuar, por ka disa çështje, disa të trashëguara nga e kaluara dhe disa nga e tashmja, të gjitha me interes të përbashkët për popujt tanë. E vlerësoj faktin që ka vullnet të mirë për t'u ulur dhe për të diskutuar këto çështje. Shpresoj që të adresohen në mënyrën më efiçente të mundshme. E dyta, Shqipëria dhe Greqia janë të interesuara për të pasur një marrëveshje për kufirin detar. Është shumë e rëndësishme që të dyja palët të hyjnë në procesin e negociatave me një mision të qartë: të arrijnë një marrëveshje që është e ligjshme, e implementueshme dhe e pakthyeshme. Në këtë kontekst, të dyja vendet janë të ndërgjegjshme se ndërkohë që janë pjesë e Konventës për të Drejtën Detare, duhet t'u nënshtrohemi ligjeve të vendeve përkatëse. Vendimi i vitit 2010 i Gjykatës Kushtetuese, që e shpalli nul marrëveshjen mes Shqipërisë dhe Greqisë për kufirin detar, ju vetëm që argumentonte pse marrëveshja e vjetër ishte e papranueshme nga ana kushtetuese, por vinte edhe piketat për një marrëveshje të ardhshme. Këto piketa tregojnë institucionet, hapat, procedurat dhe metodologjinë që mund të implementohet, nëse do të negocihohej një marrëveshje e re. Askush nuk mund t'i anashkalojë këto hapa. Nëse një prej këtyre el-

ementëve anashkalohet, injorohet, shmangët ose ndryshohet nga çdo institucion, para ose gjatë negociatave, është një shkelje e Kushtetutës. Në të njëjtën kohë, çdo marrëveshje e re që nuk respekton "vijat e kuqe", mund të mos pranohet nga Kushtetuesja. E treta, ju siguroj sërish juve dhe lexuesve tuaj se pala shqiptare, përfshirë Presidentin e Republikës dhe institucionet e tjera do të hyjnë në këtë dialog me vendosmërinë për të arritur një marrëveshje finale. Kam qenë krejtësisht transparent me institucionet shqiptare, aktorët politikë dhe opinionin publik për të pasur një marrëveshje siç duhet.

Sipas jush, marrëveshja e vitit 2009 ishte kundër interesave të Shqipërisë? Është e nevojshme një marrëveshje krejtësisht e re, apo vetëm disa amendamente në marrëveshjen e vjetër do të mjaftonin? Cfarë aspektesh duhet të mbulojnë këto amendamente?

Kjo nuk është çështje për konsiderata personale ose çështje për opinionin publik. Marrëveshja e vitit 2009 ka qenë subjekt i vendimit të Gjykatës Kushtetuese, që duhet të respektohet. Ka pasur dy alternativa të tjera, që vendet tona duhet të zgjidhnin për të përcaktuar kufirin e tyre detar. Mes tyre, të dyja palët vendosën që të rinisnin negociatat për një marrëveshje të re. Më lejoni t'ju kujtoj që Shqipëria e ka përcaktuar kufirin detar me Italinë dhe është e interesuar që ta bëjë këtë edhe me Greqinë, që do të sillte mundësinë për një marrëveshje trilaterale mes Greqisë, Shqipërisë dhe Italisë, ende pezull nga marrëveshja Shqipëri-Greqi.





Ambasadori rus mohon akuzat për ndërhyrje në zgjedhje: Spekulative

Financimi rus i PD, Karpushin: Hetimi në SHBA nuk faktoi asgjë

"Duam të përmirësojmë marrëdhëniet me Shqipërinë"

Valentina Madani

Ambasadori rus në vendin tonë, Aleksander Karpushin, mohoi dje akuzat për financimin rus të PDSH-së. Ai i quajti pretendimet për përfshirjen e Rusisë në financimin e Partisë Demokratike si spekulime të pabaza. Ambasadori Karpushin tha se nuk e kupton valën e re të sulmeve kundër Kremlinit, që mund të ketë si qëllim sipas tij, përqesimin e situatës përpara zgjedhjeve ose për të përqesuar imazhin e shtetit që do të organizojë kampionatin botëror të futbollit në qershorin e këtij viti. Ndaj Karpushin i quajti këto akuzat të pabaza, duke risjellë në vëmendjen e të gjithëve se për këtë çështje është hetuar edhe në SHBA dhe nuk është faktuar asgjë. "Të gjitha akuzat që përmenden, të gjitha këto spekulime janë të pabaza edhe për sa i përket situatës në SHBA edhe sa i përket Shqipërisë, ku kohët e fundit një akuzë e shpikur është përdorur në kontekst të betejës së brendshme politike midis PS dhe PD. Nuk e di cila është arsye për këtë valë të re akuzash kundër Rusisë kohët e fundit. Ndoshta kjo është bërë për të përqesuar situatën në prag të zgjedhjeve presidenciale", theksoi z. Karpushin. Ambasadori rus shprehet se Rusia do të përmirësojë gjendjen e saj ekonomike dhe bashkëpunimin në politikën e jashtme ku përfshihet edhe Shqipëria. "Jam besimplotë që do të vazhdojmë të përmirësojmë marrëdhëniet tona edhe me popullin shqiptar", deklaroi diplomati rus në Tiranë. Kurse tri ditë më parë ia deklaroi për "Java" në RTSH se Moskja zyrtare ka mbetur e habitur nga deklaratat e fundit që e shohin Rusinë si "perandorin e së keqes". Ai theksoi se këto i kujtojnë retorikën e Enver Hoxhës. "Kohët e fundit na kanë habitur jashtë mase përpjekjet e disa mediave shqiptare, po edhe të disa përfaqësuesve të organeve shtetërore, për demonizimin e Rusisë. Të krijohet përshytyja që qëllimi i tyre është për të bindur qytetarët shqiptarë se vendi ynë është një 'perandori e



Ambasadori rus në vendin tonë, Aleksander Karpushin

Akuzat

Ambasadori Karpushin i quajti akuzat të pabaza duke risjellë në vëmendjen e të gjithëve se për këtë çështje është hetuar edhe në SHBA dhe nuk është faktuar asgjë. "Akuzat për financimin rus janë të pabaza. Dhoma e përfaqësuesve në SHBA ka hetuar, por nga hetimet SHBA nuk u faktua asgjë", deklaroi Karpushin.

SHITBLERJA

Problematika e parë e zgjedhjeve shqiptare shënohet të jetë shitblerja e votave, pas saj vjen politizimi i organeve zgjedhore. Shtrengimi për shitblerjen e votës është i fortë në shoqëritë e varfra, ku edhe joshjet materiale modeste, si dhuratat të vogla të ushqimit ose veshjeve mund të sjellin një ndryshim të sjelljes në votim.

VOTIMET

Zgjedhjet në Rusi, deputetët shqiptarë që i vëzhguan

Rusia votoi dje për të zgjedhur presidentin e ri të federatës. Për të ndjekur mbarëvajtjen e procesit zgjedhësor janë angazhuar 555 mijë vëzhgues, lokalë dhe ndërkombëtarë. Mësohet se në përbërje të misionit vëzhgues të OSBE/ODHIR bëjnë pjesë edhe deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, Fatmir Mediu, Bledi Çuçi dhe Ervin Bushati. Ata janë vendosur në disa qendra votimi në Moskë. Ndërkohë qendrat e votimit qëndruan hapur që në 08:00 të mëngjesit dhe mbyllën në 20:00, me orën lokale të Rusisë. Votimi ishte elektronik. Në zgjedhjet për President të Rusisë morën pjesë 8 kandidatë dhe votuan 110 milionë njerëz. Në këto zgjedhje morën pjesë edhe shtetasit rusë që jetojnë në Shqipëri në qytetet e Tiranës, Shkodrës, Vlorës dhe Sarandës.



KONFERENCA

Negociatat, Rama-Bushati drejt Brukselit

Kryeministri Edi Rama dhe ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati do të udhëtojnë më 20 mars drejt Brukselit, ku do të organizohet një konferencë me pjesëmarrjen edhe të Presidentit të PE-së, Antonio Tajani, përfaqësueses së lartë të BE-së, Federica Mogherini. Konferenca është organizuar nga eurodeputeti David Sassoli dhe ajo i paraprin publikimit të 'paketës së zgjerimit', e cila do të njoftohet nga BE më 17 prill. "Shqipëria është e gatshme për të hapur negociatat për anëtarësim në Bashkimin Europian. Vitet e fundit ajo është angazhuar në reformat që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, qeverisjes, ekonomisë dhe drejtësisë", shprehet eurodeputeti Sassoli.



"Partitë në Shqipëri fshehën financimet"

Problematika, raporti: Votat u blenë në zgjedhjet e 2017-ës

Raporti për integritet të zgjedhjeve për vitin 2017, që ndër të tjera mban edhe firmën e Pipa Noris, një prej ekspertëve më të mira të sistemeve zgjedhore, e rendit Shqipërinë të vendet e moderuara sa i përket korrupsionit dhe shtrengimit të zgjedhjeve. "Top Channel" raporton se problematika e parë e zgjedhjeve shqiptare shënohet të jetë shitblerja e votave, e pas saj vjen politizimi i organeve zgjedhore. Ato cilësohen si çështje të vazhdueshme, që minojnë aspekte më të zhvilluara të zgjedhjeve, si procedurat e votimit. Në vendet ku garat janë me integritet të moderuar, Shqipëria është krahas Bullgarisë, Nepalit, Bahamasit dhe Liberisë. Këto cilësohen si vende me një seri zgjedhesh të rregullta, por problematikat që cenojnë drejtpërdrejt integritetin zgjedhor u zbrisin pikët në mënyrë



të konsiderueshme. Lidhja e korrupsionit me shtrengimin e votuesve në zgjedhje është tek abuzimi me financat politike. Ato sjellin një numër praktikash të këqija, ku më e dukshme është klientelizmi, kur qytetarët shesin votën për përfitime materiale, si para, dhuratat, vende pune, toka apo favore. Në të njëjtin rend janë abuzimi me burimet shtetërore, blerja e zgjedhjeve nga të pasurit, presioni që njerëzit të mos votojnë të lirë dhe mungesa e transparencës së llogarive financiare nga par-

titë dhe kandidatët. Korrupsioni financiar dhe mbulimi mediatic janë fushat më negative. Në Shqipëri, një Komision i Reformës Zgjedhore është ngritur dhe ka marrë përsipër të japë zgjidhje për 3 problematikat kryesore, sipas prioriteteve të OSBE-ODHIR-it, duke nisur me shitblerjen e votës, administratën zgjedhore dhe rregulla të qarta për financimin e partive. Çështja e fundit është aktuale në debatin politik në vend, për shkak të debatit që u hap pas publikimit të revistës "Mother Jones" për kontratat e lobimit të Partisë Demokratike me Nick Muzin, e dyshimet që shkrimi investigativ ngre se pas "Biniada Trade" qëndrojnë kompani ruse. Prokuroria po heton, ndërkohë pritet që gjatë javës KQZ të publikojë raportin vjetor të financave të PD-së, e cila pretendon se nuk ka bërë shkelje ligjore dhe financiare.

së keqes', ndërsa rus do të thotë armik. Deklaratat e fundit që kemi dëgjuar për "tentakulat e Moskës", të cilat goja janë shtrirë në të gjithë rajonin e Ballkanit, ngjanë më së shumti me re-

torikën e kohës së Enver Hoxhës, por aspak me deklaratat e politikanëve të një vendi modern dhe demokratik. Po të vazhdojmë të ecim me këto ritme, mund të arrijmë në një pikë kur edhe

adhuruesit e Dostojevskit dhe Tolstoit do të stigmatizohen si 'agentët e Kremlinit'. Për mendimin tim, kjo është një tendencë shumë e rrezikshme", u shpreh ambasadori rus në Tiranë.

SPONSORIZIMET LIGJI I POSAÇËM

Përurohet pallati i sportit "Dhimitraq Goga" në Durrës, premtimi i kryeministrit

Rama: Ligji për sponsorizimet në sport dhe në kulturë

"Për nismën, bashkëpunim me komunitetin"

Kryeministri Edi Rama mori pjesë dje në ceremoninë e inaugurimit të pallatit të sportit "Dhimitraq Goga" në Durrës. Pasioni për sportin e basketbollit, apo thjesht kishte ardhur koha për të mbështetur sportin? Por, kreu i qeverisë, i cili në publik të paktën ka kohë që nuk shënon më kosha, premtoi një ligj të posaçëm për sponsorizimin e sportit. Nga pallati i ri i sportit të lojërave me dorë "Dhimitraq Goga" në Xhafzotaj të Durrësit, shefi i qeverisë shqiptare theksoi se po punohet me komunitetin e sportit për t'i hapur rrugë një ligji të tillë. "Shpresoj që zëvendësministri i Sportit, një basketbollist shumë i njohur, Kostandin Shkurti, do jetë në lartësinë e detyrimit tonë për t'i mbështetur këto nisma dhe së bashku me komunitetin e basketbollit, por jo vetëm, t'i hapim rrugë edhe një ligji bashkëkohor për sponsorizimin, në mënyrë që sponsorizimi në sport e në kulturë të stimulohet dhe të jetë një rrugë për të krijuar më shumë mbështetje financiare për sportin, veçanërisht për sportet e tjera. Sepse futboli nuk diskutohet e që sidogoftë, i ka disa mundësi që sportet e tjera nuk i kanë dhe është shumë më tepër një industri sesa thjesht një sport", deklaroi z.Rama. Prej kohësh Federata e Sporteve kërkon hartimin e një ligji të tillë, që sipas tyre jo vetëm ndihmon ekipet, por edhe do të përmirësojë imazhin e sportit në botë. Ligji do t'u jepte më shumë autonomi përmes përcaktimit të kompetencave dhe do të sillte një lloj ndërgjegjësimi në menaxhimin e fondeve. Në fjalën e tij, kreu i qeverisë tha se nuk e prishte kurrë surprizë dhe infrastrukturën dinjitoze të pallatit të ri të sportit, duke theksuar se do t'i hapet rruga një ligji për sponsorizimet në sport dhe kulturë. "Nuk e mendoja që do gjeja një infrastrukturë dinjitoze të një pallati sporti në të gjithë kuptimin e fjalës dhe mirënjohja i shkon ideatorit dhe të shërbejë kjo për t'u shtuar në të gjithë vendin",



Kryeministri Edi Rama dhe zëvendësministri i Sportit Kostandin Shkurti në inaugurimin e pallatit të sportit "Dhimitraq Goga" në Durrës

PREMTIMI

"Shpresoj që zv.ministri i Sportit të jetë në lartësinë e detyrimit tonë për t'i mbështetur këto nisma dhe bashkë me komunitetin e basketbollit t'i hapim rrugë një ligji për sponsorizimet në sport dhe në kulturë dhe të jetë një rrugë për më shumë mbështetje financiare për sportin", theksoi z.Rama.

Inceneratorët, Vasili: Bota i dënon si shkaktarë të kancerit, ne mbyllim sytë

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili deklaroi dje se inceneratorët në Francë dënohen në gjykatën penale pasi shkaktojnë kancer, ndërsa në Shqipëri prokuroria mbyll sytë. Ai shprehet se mbeturinat e inceneratorëve është provuar shkencërisht se shkaktojnë kancer. "Inceneratorët dënohen në gjykatën penale të Parisit se shkaktojnë kancer, prokuroria mbyll sytë në Shqipëri. Mbeturinat e inceneratorëve është provuar shkencërisht që shkaktojnë kancer të përhapur të gjëndrave limfatike dhe të tjerë. Ky ka qenë edhe shkaku se pse Europa ka bërë kufizimin drastik të tyre. Megjithatë Europa ka mundësi kontrolli dhe monitorimi shumë të rre-



ta, që s'kanë asnjë krahasim me kontrollin e korruptuar dhe joprofesional në Shqipëri, por kufizimi i tyre ka qenë drastik, sepse rreziku i shkaktoimit të kancerit është shumë i lartë. Gjykatat Penale e Parisit dënoi më 6 mars për herë të parë në Francë, bashkimin e kompanive 'Melunin' për shkak të ndotjes ambientale të sh-

Deklarata

"Inceneratorët dënohen në gjykatën penale të Parisit se shkaktojnë kancer, prokuroria mbyll sytë në Shqipëri. Mbeturinat e inceneratorëve është provuar shkencërisht që shkaktojnë kancer të përhapur të gjëndrave limfatike dhe të tjerë", tha z.Vasili.

kaktuar nga inceneratori i përpunimit të mbetjeve", tha z.Vasili. Por sipas tij, "në Shqipëri kush ia mbyll sytë prokurorisë që ta hetojë, pse nuk vepron, apo mijëra shqiptarë le të sëmuren e vdesin me kancer, vetëm aferat e qeverisë të mos hetohen. Kjo është kriminale dhe antihumane".

një vlerësim maksimal krijesit të këtij pallati sporti, i cili ka nderuar një legjendë të basketbollit në emër të madh, Dhimitraq Goga, i cili ka qenë plejada e parë që e ka ngritur emrin e basketbollit shqiptar në arenën ndërkombëtare", tha kryeministri Rama.

theksoi z.Rama. Gjatë fjalës së tij, kryeministri Rama shtoi se do t'i jepte një vlerësim maksimal krijesit të këtij pallati fantastik, Iglu Goga, që ka nderuar një legjendë të basketbollit shqiptar: Dhimitraq Goga ka qenë plejada e parë pas luftës e që e ka ngritur basketbollin në nivele



Kreu i opozitës, Lulzim Basha me deputetët e PD-së



Ish-ministri: Rilindja ka vetëm një ilaç, drogën

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, ngriti dje shqetësimin mbi medikamentet mjekësore që qarkullojnë në Shqipëri. Manjani shkruan se sa herë udhëton jashtë, bën shopping në farmaci, ndërsa shton se faji në Shqipëri nuk është i mjekëve dhe as i farmacistëve, por i pushtetit grosist dhe lektist. "Asnjë lloj ilaçi që blihet këtu nuk bën punë! As ilaçet bazike (paracetamol, ibuprofen, voltaren apo qetësues të tjerë). Ato më të komplikuarat jo e jo! Të njëjtat ilaçe të blera jashtë veprojnë menjëherë! Sa herë jam jashtë shteti bëj një shopping në farmaci. Blej drogë që më del para syve dhe që mund të jepet pa recetë! Por kur të mbarojnë rezervat, o Zot sa e vështirë! Lypim tek shogonia noi ilaç të blerë jashtë. Nuk kam besuar ndonjëherë të shëndetësia falas, por edhe me lekë nuk gjen derman! Nuk është faji i mjekëve, as i farmacistëve, por i pushtetit grosist dhe lektist! Farmako-vigilanca nuk ekziston fare! Farmako-rilindja, ka vetëm një ilaç efektiv, drogën! Këtë s'na e mban ta fillojmë, me thënë të drejtën. Mezi po pres rrugën tjetër jashtë shteti. Jam keq me voltaren", shprehet z.Manjani.



Deputeti i PD publikon videon: Filmi i parë për qeverinë "Rama"

Deputeti i PD-së, Klevis Balliu, publikoi dje një video si një film me karikatura, ku personazhe janë politikanët. Nga kryeministri Edi Rama, tek ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri, ish-kryeministri Sali Berisha, kreu i PD-së Lulzim Basha por edhe personazhe të botës së kimit si Habilajt e Balli janë pjesë e këtij filmi, që sipas Balliut është historia e vërtetë e kimit në pushtet. Në video, personazhet që inkorporojnë kryeministrin Rama dhe ish-ministrin Tahiri flasin për para, drogë, vjedhjet. "Kjo është historia e vërtetë e kimit në pushtet. Qeveria e Ramës dhe bandave të narkotrafikut", shkruan Balliu. "Filmi" i deputetit të PD është përgjyeshëm me porositë e Ramës për ministrat, por edhe komunitetin e tij me Habilajt dhe Balliajt, gjithmonë sipas Klevis Balliut. PD dhe opozita në tërësi akuzojnë qeverinë "Rama" si të lidhur me krimin dhe drogën, ndërsa kjo nuk është herë e para që deputetët e djathtë ironizojnë qeverinë me në krye Ramën përmes animimeve të ndryshme.



Projekti për ndryshimet statutoare, shqyrtimi në dorë të juristëve demokratë

Kuvendi i PD-së, grupi i punës takime me kritikët e Bashës

Mbledhja, më 25 mars gati lista e delegatëve

Valentina Madani

Grupi i posaçëm i punës, i ngritur me propozim të kryetarit Lulzim Basha dhe miratim të kryesisë së PD-së, i parakthuar për mbledhjen e propozimeve për ndryshimet në statutin e partisë dhe riorganizimin e saj, pritet të mbledhë punën brenda tri ditëve. Ky grup pune do të përfundojë mbledhjen e propozimeve brenda datës 22 mars, ku më pas ngarkohet departamenti ligjor për shqyrtimin e tyre. Deri në 22 mars grupi i punës pret propozimet nga çdo anëtar për ndryshimin e statutit të PD-së. Kurse më 25 mars krerët e degëve duhet të sjellin listën e delegatëve për Kuvendin Kombëtar, që do të mbahet në datat 28-29 prill. Kryesia e PD-së në mbledhjen e fundit mandatoi dy nënkryetarët, Paloka dhe Spaho, sekretarin e përgjithshëm Ristani, sekretarin organizativ Enno Bozdo dhe sekretarin për burimet njerëzore Kadilli, që të vendosin kontakte dhe të mirëpresin çdo propozim për ndryshimin e statutit të Partisë Demokratike, si pika e nisjes për bashkimin e kësaj force politike. Një grup anëtarësh kërkon një ringritjen e partisë dhe sekretari i përgjithshëm i PD-së, Arben Ristani shprehet se po punohet që të përfshihen idetë e të gjithëve, me qëllim bashkimin kundrejt qeverisë. Ristani ka konfirmuar se është takuar me Ridvan Boden, por edhe me kritikë të tjerë të Bashës, propozues të platformës për ringritjen e PD-së dhe projekt-statutit. Pikërisht pjesë e këtyre propozimeve janë Platforma për ringritjen e PD-së, që mban firmëtarë disa figura të vjetra të partisë si Astrit Patozi dhe Ridvan Bode si dhe projektstatuti që mban firmën e anëtarëve të Këshillit Kombëtar Edith Harxhi dhe Edvin Kulluri prej nëntorit 2017, kur PD ishte ende në proces analize. Sa i përket kësaj të fundit. Nënkryetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka është shprehur se në këto ditë pune deri më tani të grupit të ngritur për mbledhjen e propozimeve për statutin e partisë demokratike, rol kanë luajtur edhe raportet e analizës së degëve, të cilat mbartin



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

DELEGATËT

Deri në 22 mars grupi i punës pret propozimet nga çdo anëtar për ndryshimin e statutit të PD-së. Më 25 mars, krerët e degëve duhet të sjellin listën e delegatëve për Kuvendin Kombëtar, që do të mbahet në datat 28-29 prill.

propozime të ndryshme për riorganizimin e partisë. "Gjatë procesit të analizës dhe në raportet e përgatitura nga degët, kanë ardhur dhe propozime që kanë të bëjnë me ri organizimin, jo direkt për propozime, por ide për ndryshimet në statusin e PD-së, për mënyrën e funksionimit të PD-së në të ardhmen. Të gjitha këto do të mer-

ren, do të përkthehen edhe në ndryshime në statut dhe do të shqyrtohen jo nga grupi i punës, por nga juristët e PD, të cilët do të na sjellin projektin konkret të ndryshimeve statute apo ndryshimeve të tjera që kërkohen", tha z.Paloka. Pjesë e procesit të analizës dhe konsultencës ka qenë edhe verifikimi i anëtarësisë në çdo njësi

organizative të PD-së. Verifikimi është kryer paralelisht me analizën dhe i gjithë procesi është koordinuar nga sekretari organizativ i partisë z.Enno Bozdo. Ky verifikim ka ndodhur në pjesën dërmuese të degëve dhe pritet të mbyllet brenda dy javësh. Një porosi specifike e z.Bashas në mbledhjen e kryesisë ishte që drejtuesit në bazë nuk duhet të lënë jashtë vëmendjes takimet me qytetarët. PD synon që të gjithë procesin e ristrukturimit të saj në bazë dhe në degë ta përmbyllë deri në fund të qershorit, për t'u bërë gatë për zgjedhjet vendore të vitit 2019.

Ironia e Bylykbashit: 'Peshk i egër apo rezervati...'

Deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi, përmes një komenti në rrjetet sociale ironizoi dje arrestimet me "peshqit e mëdhenj". Bylykbashi shkruan se kur shih lajmet që policia ka kapur "peshk të madh" duhet pyetur është rezervati apo i egër. "Hormon 'big fish'. Kur të shesin peshk të rritur me hormone. Kur shih lajmet që policia kap 'peshk të madh', duhet pyetur si në restorant: është peshk i egër apo peshk rezervati?", shkruan Bylykbashi.



Strazimiri: S'të ndëshkon më drejtësia, por kryeministri...

Deputeti i PD-së, Gent Strazimiri shprehet se nga sot nuk të ndëshkon më drejtësia, por qeveria e një partie të vetme, madje personalisht kryeministri. Strazimiri shkruan në 'FB' se drejtësia me gjithë problemet nga të cilat vuante sistemi, rezistoi deri ditën kur dhunshëm kaloi zyrtarisht nën sundimin politik monist. "Që të kuptojmë më mirë se ç'po ndodh e ç'e pret vendin e shqipeve! Kishte më pak se 90 ditë që sundonte dhe urdhëronte ndëshkime për kundërshtarët politikë! Drejtësia, me gjithë problemet nga të cilat vuante sistemi, rezistoi... deri ditën kur dhunshëm kaloi zyrtarisht nën sundim politik monist! Sot, problemeve që kishte, iu shtua edhe kanceri terminal: korrupsioni politik! Nga sot, nuk të ndëshkon më drejtësia, të ndëshkon qeveria e një partie të vetme, madje personalisht kryeministri!", tha Strazimiri.



Denoncimi te Berisha, lidhjet e policisë me krimin

Përfshirja e Policisë së Shtetit në trafikun e drogës në vendin tonë tashmë është një fenomen i cili po shqetëson të gjithë qytetarët shqiptarë. Një qytetar denoncoi lidhjet e drejtuesve të Policisë së Shtetit me një prej trafikantëve të arrestuar pak ditë më parë. Denoncimi u bë dje nga ish-kryeministri Berisha. "Denoncohet klani i trafikantëve me uniformë". "Lajmi është i paralajmëruar. Artur Karaj, i arrestuar për favorizim të kalimit të paligjshëm të kufirit është vëllai i Xhevahir Karajt nga Fushë-Kruja, ish-drejtorit të Policisë Shkodër, Vlorë e i shumë posteve të dhëna nga rindija mbas vitit 2013 nga zyra e burimeve njerë-



zore në Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe në atë Drejtorisë së Kufirit. Artur Karaj është dhe vëllai i Esat Karajt, që ka një gjysmë shekulli në Policinë e Shtetit e vëllai i Agim Karajt, që punon në zjarrfikëset e Rinas. Artur Karaj, përgjegjës në 'Sekuriteti Aeroport Partners' Ri-

nas ka 8 vite që merret me trafikun e njerëzve dhe pas punësimit në 2013 të Xhevahir Karajt, ai e ktheu lokalim ku rrinte në Fushë-Krujë në zyrë emigracioni e punësimi në polici e në 'ICTS Aeroport Partners' Rinas", thuhet në mesazhin dërguar z.Berisha.

NJOFTIM ANKANDI

Përmbareus gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandet sipas datave të mëposhtme:

Date 16/04/2018, ditën e Hënë, ora 16:00, përfundon ankandit i ri (i dytë), për shpirtin e pasurive të paluajshme të llojit "Ari" me sip. 7400 m2, e ndodhur në fshatin Bëtime Devoll, në vlerën 414,400 leke. Pasuritë janë lene garanci bankare nga debitori Trashëgimtareve të të ndjerit/Debitor znj. Bukurije Suljejan Fazo, znj. Mimoza Fatmir (Foto) Fazo, z. Xhimi Foto Fazo, znj. Arkonda Foto Fazo, znj. Elvira Foto Fazo, znj. Luiza Foti (Kosabelli) Fazo banues në fshatin Bëtime, bashkia Devoll, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sht.a, me seli në ish Blliku Tiranë.
Ankandit zhvillohet pranë zyrës së përmbareusit me seli lagjen nr.3, Rruga Avni Rustemi, nr.31 k.1, Korçe. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

Klandestinë me pasaporta false, ja sa varionin pagesat te trafikantët

Trafikuan shqiptarë në SHBA, Kanada dhe Britani, zbulohen drejtuesit e grupeve kriminale

Zbardhet e shkuara e errët dhe bizneset që disponojnë të arrestuarit

Në kuadër të operacionit të koduar "One If-By Land" u goditën nga policia shqiptare në bashkëpunim me autoritetet në SHBA, Kanada, EUROPOL dhe INTERPOL shtatë grupe të strukturuar kriminale, që trafikonin emigrantë të paligjshëm në shumë vende të botës. Ky operacion solli arrestimin e 39 personave mes të cilëve 4 efektivë policie, ndërkohe që janë shpallur në kërkim dhe 12 shtetas të tjerë. Dy ditë pas finalizimit të këtij megaoperacioni zbulohet e shkuara kriminale e disa prej personave të arrestuar, të cilët mendohet të jenë drejtues në këto organizata kriminale. Gjithashtu, mësohet se disa prej të arrestuarve janë akzionerë dhe disponojnë biznese të ndryshme në Shqipëri.

DREJTUESIT E GRUPEVE KRIMINALE

Në kuadër të goditjes së kontrabandimit të personave me qëllim emigrimin drejt SHBA-ve, Kanadasë, Mbretërisë së Bashkuar etj., dy ditë më parë u përmbyll operacioni i koduar "One If-By Land", ku ranë në pranga 39 persona dhe u shpallën në kërkim 12 të tjerë. Mësohet se operacioni i drejtuar nga prokurori Eugen Beci është zhvilluar në disa qytete të vendit tonë, konkretisht në Tiranë, Lezhë, Kukës, Fier, Dibër, Shkodër dhe Korçë. Organizata kriminale ishte e ndarë në 7 grupe të strukturuar. Bëhet me dije se hetimi ndaj këtyre grupeve kriminale ka nisur në muajin mars të 2017-ës. Pas arrestimit të disa prej personave të përfshirë në trafikim, zbardhen emrat e drejtuesve të këtyre grupeve. Bëhet fjalë për Ardian Corri, Nik Bushin, Kol Vushaj, Zaim Hysenbelliu dhe Nikolin Priska, deklaruar "A1 Report". Bëhet me dije se Ardian Corri, 47 vjeç, lindur në Krujë dhe banues në Tiranë, vepronte në Lezhë. Ai njihet nga policia dhe prokuroria si person me të kaluar kriminale. Corri rezultoi i dënuar më parë nga drejtësia shqiptare për trafikim, zbardhen emrat e drejtuesve të këtyre grupeve. Bëhet fjalë për Ardian Corri, Nik Bushin, Kol Vushaj, Zaim Hysenbelliu dhe Nikolin Priska, deklaruar "A1 Report". Bëhet me dije se Ardian Corri, 47 vjeç, lindur në Krujë dhe banues në Tiranë, vepronte në Lezhë. Ai njihet nga policia dhe prokuroria si person me të kaluar kriminale. Corri rezultoi i dënuar më parë nga drejtësia shqiptare për trafikim, zbardhen emrat e drejtuesve të këtyre grupeve. Bëhet fjalë për Ardian Corri, Nik Bushin, Kol Vushaj, Zaim Hysenbelliu dhe Nikolin Priska, deklaruar "A1 Report". Bëhet me dije se Ardian Corri, 47 vjeç, lindur në Krujë dhe banues në Tiranë, vepronte në Lezhë. Ai njihet nga policia dhe prokuroria si person me të kaluar kriminale. Corri rezultoi i dënuar më parë nga drejtësia shqiptare për trafikim, zbardhen emrat e drejtuesve të këtyre grupeve. Bëhet fjalë për Ardian Corri, Nik Bushin, Kol Vushaj, Zaim Hysenbelliu dhe Nikolin Priska, deklaruar "A1 Report".



Momenti i arrestimit të trafikantëve

2014. Ndërsa Nikolin Priska dyshohet se ka qenë anëtarë i grupit "Go-West", që falsifikonte viza amerikane dhe 29 shtete të tjera. Sipas burimeve nga policia, personat e përfshirë në trafikim e klandestinëve, pasi dublikonin pasaportat, vidhnin

identitetet dhe më pas vendosnin fotot e personave që interesoheshin për të ikur në SHBA, Kanada etj. Dy ditë më parë drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu ka zbardhur emrat e 39 personave që u arrestuan, ndërsa ka dhënë detaje për opera-



Pagesat

Sipas hetimeve të prokurorisë, mësohet se për trafikimin drejt Britanisë së Madhe grupet kriminale merrnin nga 7 mijë paund për person. Ndërsa për në SHBA dhe Kanada personat e arrestuar merrnin nga 25 mijë dollarë deri në 30 mijë dollarë. Për këto grupe kriminale janë në total 51 urdhër arreste, prej të cilave 39 të ekzekutuara dhe për 12 persona vazhdon ende operacioni pasi nuk janë kapur.

cionin. Katër policët e arrestuar janë me detyrë kontrollore në Pikat e Kalimit Kufitar, Hani i Hotit dhe Qafë Thanë, të cilët kanë shpërdoruar detyrën duke mos kryer regjistrimin e shtetasve të kontrabanduar. Sakaq, sipas burimeve zyr-

tare nga Policia e Shtetit, itineraret që përdornin pjesëtarët e 7 grupeve të strukturuar kriminale janë: Shqipëri-Itali-Mbretëri e Bashkuar, Shqipëri-Francë-Mbretëri e Bashkuar, Shqipëri-Bullgari-Belgjikë-Republika Domeni-

kane-SHBA/Kanada dhe Shqipëri-Spanjë-Amerika Latine-SHBA/Kanada.

BIZNESET

Mësohet se një prej të arrestuarve, i cili dyshohet të jetë drejtues i grupeve të strukturuar kriminale, Ardian Corri që prej vitit 2014 disponon bar-restorant në plazhin e Shëngjinit në Lezhë. Gjithashtu, në 1 nëntor 2017 ka themeluar kompaninë "CORRI-DL". Objekti i këtij aktiviteti është kërkim, zbulim, shfrytëzim dhe përpunim i mineraleve të ngurta dhe nikeli në të gjithë zonën eksport-import në tregun e lirë industrial si brenda dhe jashtë vendit. Vihet re se në 31 janar 2018 Corri ka vendosur të pezullojë pa afat aktivitetin tregtar të kësaj kompanie. Një ndër të arrestuarit e tjerë, Nik Bushi rezultoi se prej vitit 2012 merret me tregti me pakicë rroba të përdorura në Shkodër. Ndërkohë, i arrestuari Ardian Guraquqi, rezultoi të jetë pronar i një bar-kafe në kryeqytet.

Astrit Thaçi, nën akuzë për "Shkatërrim prone", "Përndjekje"...

Në kërkim nga autoritetet zvicerane, kapet në Morinë 33-vjeçari kosovar

KUKËS - Policia kufitare ka vënë në pranga ditën e djeshme një 33-vjeçar Kosovar, pasi ishte shpallur në kërkim nga autoritetet zvicerane. Specialistët e Policisë Kufitare Morinë bënë arrestimin provizor. Me qëllim ekstradimit të shtetasit Astrit Thaçi, 33 vjeç, banues në Xërxë, Kosovë të shpallur në kërkim ndërkombëtar. Ky shtetas u kap në hyrje të SPK Morinë, ku gjatë regjistrimit në sistem rezultoi person në kërkim ndërkombëtar nga autoritet zvicerane. Gjykata De La Broye Et Du Nord Vaudois, Yverdon-Les-Bains/Zvicër, datë 14.02.2013, e ka dënuar me 18 muaj burgim për kryerjen e veprave penale "Shkatërrimi i pronës",



"Përndjekja", "Shkelje e Ligjit federal për të Huajt". Gjithashtu, gjykata De La Broye Et Du Nord Vaudois, Yverdon-Les-Bains/Zvicër, datë 27.12.2016, e ka dënuar me 6 muaj burg, për veprën penale, "Marëdhënie seksuale me dhunë e mbetur në tentativë". Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës për veprimet të mëtejshme.

PERMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT ERMIR GODAJ

*Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e trete per shiljen e pasurive te paluajtshme :

1. Apartamenti me Nr. pasurie 118/57+2-10, ZK 3292, vol 38, faqe 184, me sipërfaqe 94.5 m², te ndodhur ne Selite, Tirane;
2. Apartamenti me Nr. pasurie 118/57+2-11, ZK 3292, vol 38, faqe 185, me sipërfaqe 99 m², te ndodhur ne Selite, Tirane;

per shlyerjen e detyrimit te favor te kreditorit Shoqerise "EDIL-AL-IT" Sh.p.k. ne shumat 67'927(gjashthdjetje e shtate mije e nenteqind e njezete e shtate)Euro dhe 309'225(treqind e nente mije e dyqind njezete e pese) Leka.

Çmimet me të cilat fillon ankandi i trete jane ne vlerat :

1. Apartamenti me nr. pasurie 118/57+2-10, ZK 3292, vol 38, faqe 184, me sipërfaqe 94.5 m², te ndodhur ne Selite, Tirane, ne shumen 40'484(dyzete mije e katerqind e tetedhjetje e kater)Euro;
2. Apartamenti me nr pasurie 118/57+2-11, ZK 3292, vol 38, faqe 185, me sipërfaqe 99 m², te ndodhur ne Selite, Tirane, ne shumen 41'983(dyzete e nje mije e nenteqind e tetedhjetje e tre)Euro;

Ankandi i trete zhvillohet ne date 03.04.2018, ora 16.00 ne zyren e permbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", Qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0695370060, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.*

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQËSORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

A. Automejletit tip "SKODA", ngjyrë "GRI", vit prodhimi '2009', nr. shasia TMBDQ41U4A8840601, me targë "TR 2338 T", në pronësi të dorëzimit z. ALKET Suard KOTONI, ÇMIMI 120.000 LEKË;
B. Automejletit tip "HYUNDAI", ngjyrë "GRI", vit prodhimi '2009', nr. shasia MALAM51CBAM416803, me targë "AA 714 BH", në pronësi të dorëzimit z. ALBA Luan KOTONI , ÇMIMI 130.000 LEKË.
Data e zhvillimit të ankandit do jetë 21.03.2018 .
CEL. 0684026666 ; 0693262866

SHKURTE

Plagosi me armë zjarri 52-vjeçar, bie në pranga i riu nga Hasi

KUKËS - 30-vjeçari Abedin Cenalia ka rënë ditën e djeshme në pranga e policisë së Kukësit, pasi akuzohet për tentativë vrasjeje. Specialistët e Seksionit Kundër Krimeve ndaj Jetës dhe Lirisë së Personit arrestuan në flagrancë shtetasin Abedin Cenalia, 30 vjeç, banues në fshatin Vranishtë, Has. Arrestimi i tij u bë pasi në qytetin e Krumës, pas një konflikti për motive të dobëta, ka tentuar të vrasë me armë zjarri duke e plagosur në këmbë shtetasin S.Sh., 52 vjeç, banues në fshatin Vranishtë, Has. I plagosuri ndodhet në spitalin Ushtrarak Tiranë, jashtë rrezikut për jetën. Shërbimet e policisë pas kontrolleve dhe krehjes së zonës, bënë të mundur kapjen dhe arrestimin e autorit. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua arma e zjarrit pistoletë, tip "MINI-BLOU", ku dyshohet që është përdorur nga autori për plagosjen e shtetasit S.Sh. Materialet u referuan në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës, për veprat penale "Vrasja me dashje, mbetur në tentativë" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit".

Sherr për motive pronësie, përfundojnë të plagosur xhaxha e nip

ELBASAN - Një konflikt për motive pronësie, xhaxha e nip ka degraduar në plagosjen arrestimin e tyre. Uniformat blu bëjnë me dije se ngjarja ka ndodhur në fshatin Murriqan të Elbasanit, ku janë arrestuar Ervin Preçi, 38 vjeç dhe nipi i tij L.Preçi, 17 vjeç. Policia thotë se arrestimi i tyre u bë pasi në fshatin Murriqan, pas një konflikti për motive të dobëta pronësie, xhaxha dhe nipi dyshohet të kenë goditur njëri-tjetrin me sende të forta. Si pasojë janë dëmtuar të dy shtetasit, të cilët ndodhen në spitalin Kirurgjik Elbasan nën kujdesin e mjekëve. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprimet të mëtejshme për veprën penale "Dhuna në familje".

Julian Sulo, 37 vjeç është arrestuar ditën e djeshme nga Policia e Lushnjës dhe FNSH-të e Fierit, pasi nuk i është bindur policisë për të ndaluar, ndërsa lëvizte me makinë të blinduar. Gjatë kontrollit të ushtruar nga policia në lagjen "Gafur Muço", shtetasi Julian Sulo duke udhëtuar me mjetin tip "BMW" të blinduar, nuk i është bindur urdhrat të punonjësve të policisë për të ndaluar. Policia iu vu në ndjekje shtetasit të lartpërmendur, i cili pasi braktis makinën, hedh armën që mbante në mjet dhe largohet me vrap në rrugicat e qytetit.

Me "BMW" të blinduar dhe armë pa leje, kush është Julian Sulo "Juli i Pashakos" nuk i bindet policisë, bie në pranga biznesmeni lushnjjar

NGJARJA

Gjatë kontrollit të ushtruar nga policia në lagjen "Gafur Muço", shtetasi Julian Sulo duke udhëtuar me mjetin tip "BMW" të blinduar, nuk i është bindur urdhrat të punonjësve të policisë për të ndaluar. Policia iu vu në ndjekje shtetasit të lartpërmendur, i cili pasi braktis makinën, hedh armën që mbante në mjet dhe largohet me vrap në rrugicat e qytetit.

FNSH Fier, u bë e mundur kapja e këtij shtetasi në lagjen "18 Tetori", Lushnje. Në afërsi të mjetit është gjetur një pistoletë tip "Grand

Power" Q 100, një krehër me 15 fishekë dhe një fishek në folenë e fishekut, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Mësohet

se 37-vjeçari ka një lokal dhe një lavazh në qytetin e Lushnjës dhe nuk është person i panjohur për policinë. Ai njihet në Lushnjë edhe si "Juli i Pashakos". Ai ka qenë një nga personat e shoqëruar si të dyshuar për masakrën në Lushnjë, ku u ekzekutuan Jurgen Hoxha dhe Zamir Latifi, miq të nipit të Aldo Bares, Laert Haxhiut. Sula u vetëdorëzua në polici pas vrasjes së dy të rinjve, por u lirua më pas për



mungesë provash. Një tjetër ngjarje është ajo e gati dy viteve më parë, më 11 qershor 2016 kur Julian Sulo u plagos pas ndeshjes Shqipëri-Zvicër në një pikë bastesh, në lagjen "Skënder Libohova". Lokali në fjalë ishte në pronësi të Arjan Aliços, i njohur ndryshe si "Arti i Braçes" një

53-vjeçar, i dënuar më parë për vrasje dhe që njihet si një nga ushtarët e Aldo Bares. Ai u qëllua me thikë rreth 20 herë dhe me leva aq sa u la si i vdekur buzë rruge dhe u shpëtua nga një kalimtar i rastit. Arjan Aliçko mori përsipër krimin dhe ndodhet në burg.

Nën akuzë për tjetërsimin e pronave në bregdetin e Shëngjinit, prapa hekurave 12 zyrtarë

Arrestimi i kryebashkiakut të Lezhës, simpatizantët para komisarariatit: Lirojeni

Dosja "Rana e Hedhun", Fran Frrokaj para gjykatës për masën e sigurisë

Qytetarë të shumtë janë mbledhur ditën e djeshme në dyert e policisë së Lezhës kundër arrestimit të kreu të bashkisë, Fran Frrokaj. Ky i fundit ra në prangat e policisë tri ditë më parë, së bashku me disa zyrtarë të tjerë, pasi akuzohet për tjetërsim pronash në bregdetin e Shëngjinit. Ndërkohë, simpatizantët e Frrokajt protestuan para komisarariatit duke kërkuar lirimin e tij. Ata e quajtën të padrejtë dhe politik arrestimin e kryebashkiakut. Ndërkohë, Gjykata e Lezhës do të zhvillojë sot seancën për rivlerësimin e masës së arrestit për kryetarin e Bashkisë së Lezhës, Fran Frrokaj dhe 11 zyrtarëve të tjerë. Në seancë pritet që gjykata të vendosë nëse Frrokaj do të gjykohej në paraburgim apo i lirë. Kryebashkiaku, përfaqësues i PD-së, akuzohet për 'shpërdorim detyre', pasi ka dyshime se ka tjetërsuar pronat tek "Rana e Hedhun" në Shëngjin. Gjithashtu, pas hekurave përfunduan edhe nënkryetari i bashkisë, Enver Hafizaj, kreu i hipotekës, Gjelina Bacaj, bashkë me dy juristë Eduard Lekaj e Armando Daka.

PROTESTA

Familjarë dhe punonjës të administratës kanë qëndruar ditën e djeshme para komisarariatit të Lezhës duke kundërshtuar arrestimin e kryebashkiakut, Fran Frrokaj. Ata kanë nisur të grumbullohen përpara hyrjes së komisarariatit duke kërkuar lirimin e tij. Simpatizantët pretendojnë se Frrokaj nuk ka asnjë lidhje me



Kreu i Bashkisë së Lezhës, Fran Frrokaj

tjetërsimin e pronave bregdetare. "Arrestimi është i pabazë. Është komplet një skenë e inskenuar politike. E konsideroj totalisht një arrestim politik. Bëj thirrje që drejtësia të mos jetë me dy standard. Frrokaj është ndodhur në qytetin e tij, pranë banorëve të tij. Nuk e dimë për çfarë akuzohet kryetari, nuk ka prova", tha njëri prej mbështetësve të kryebashkiakut. Më herët, kryetari i Partisë Demokratike, Luzlim Basha në një takim me strukturat e selisë blu, ka deklaruar se shpreson që Frrokaj të jetë i pafajshëm dhe se PD kërkon hetim të paanshëm, jopoli-

tik dhe profesional. "PD kërkon zbatimin e standardit se të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Është e rëndësishme që të mos këtë drejtësi selektive, në funksion të një axhede politike të caktuar", është shprehur Basha.

ARRESTIMET

Drejtori i Policisë së Lezhës, Ferdinand Mara ka njoftuar tri ditë më parë se 12 zyrtarë kanë rënë në prangat e policisë, pasi akuzohen se kanë tjetërsuar pronat në bregdetin e Shëngjinit. Ndërkohë 11 të tjerë janë shpallur në kërkim. "Deri tani janë arrestuar dhe ndaluar 12 zyrtarë publikë



Protesta para komisarariatit në Lezhë

dhe janë shpallur në kërkim 11 zyrtarë e shtetas të tjerë, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin, duke abuzuar me detyrën kanë falsifikuar, tjetërsuar dhe përvetësuar 234,548 m2 tokë shtetërore rarishte në zonën bregdetare Shëngjin, tek vendi i quajtur "Rana e Hedhun". Kjo sipërfaqe është shndërruar me dokumente të falsifikuara nga tokë shtetërore në bregdet, në tokë arë dhe pemëtore. Më pas është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Lezhë (ZRPP), duke përfutur padrejtësisht në interes të tyre dhe personave të tjerë. Këto hetime

proaktive janë kryer në funksion të procedimit Penal regjistruar në vitin 2017, për veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Falsifikimit i dokumenteve", tha të premtën drejtori i Policisë së Lezhës, Ferdinand Mara. Ndërkohë, prokuroria pritet të zgjerojë hetimet për përvetësimin e mbi 235 mijë metrave krrorë tokë në zonën e Quajtur Rana e Hedhun. Burime pranë organit të akuzës thanë se hetimet do të shtrihen dhe në zonat e tjera bregdetare të Shëngjinit, por edhe në Veli-pojë të Shkodrës, ku dyshohet se ka pasur abuzime me titujt e pronësisë.

SHKURT

Ekuador, ekzekutohet me 3 plumba shqiptari dhe bashkëshortja e tij

EKUADOR - Një 64-vjeçar shqiptar dhe bashkëshortja e tij janë vrarë me armë zjarri në Ekuador. Mësohet se Fadil Kaçaniqi, shtetasi i Malit të Zi, u ekzekutua me tri plumba, ndërsa bashkëshortja e tij 63-vjeçare Fatima gjeti vdekjen pasi u godit me sende të forta në kokë. Mediat vendëse raportojnë se në vendin e ngjarjes u gjetën gjurmët balistike dhe guri për të cilin dyshohet se është shfrytëzuar si armë. Sipas portalit ekuatorian "Extra", vrasësit u preztuan si policë që kërkuar të ushtronin kontroll. Gjenerali policor Marcelo Tobar theksoi se Kaçaniqi kishte dosje kriminale për shkak të trafikut të lëndëve narkotike, ndërsa gruaja e vrarë punonte në aeroportin Zhoze Zhakin de Olmedo.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 109 / 229 + 3 - 6, e llojit 'Apartment', zona kadastrale 3292, volumni 24, faqe 166, sipërfaqe totale 110, 5 m2, në pronësi të AMARILDO NAÇO, me adresë: Selitë , Tiranë .
ÇMIMI 5.890.500 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 12.04.2018 .
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 7 / 392 - G8, e llojit 'Garazh', volumni 20 , faqe 143, zona kadastrale 8370, me sipërfaqe totale 19.94 m2, në pronësi të SHOQËRISË "IN CO" SHPK, NUIS: J62410017G, me adresë: Ruga "4 Dëshmorët", Tiranë .
ÇMIMI 2.000 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 11.04.2018
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURINË NR. 2/963-ND1-43 , E LLOJIT 'APARTAMENT', VOLUMI 55 , FAQEJE 73, ZONA KADASTRALE 8513, ME SIPERFAQJE 67.81 M2, NE ADRESËN: RRUGA "K. KËRTUSA", SHKALLA 1 , KATI 7 , DURRES , NE PRONËSI TË SHITASVE : Z. LUTFI GJYZELI DHE ZNJ. ENKELEJDA GJYZELI .
ÇMIMI 2.000.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 11.04.2018 .
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

PUNESIMI I INFERMIEREVE INTERVISTA

"2-3 javë, të pamjaftueshme për të shqyrtuar rreth 3500 dosjet e aplikantëve"

Elson Jaçaj: Portali për infermierët, dështim i hapur

"Punësimet janë bërë politikisht, me mik apo lekë"

Voltiza Duro



Të gjithë ata që kanë përfunduar studimet e larta për infermieri, kanë mundësinë të aplikojnë nëpërmjet portalit "Infermierë për Shqipërinë". Disa ditë më parë u bë me dije se në datën 15 mars të këtij viti do të shpallehin e emrat e kandidatëve fitues që kalojnë fazën e parë, por deri më tani ende nuk ka një njoftim. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", kreu i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, Elson Jaçaj thotë se ky portal për punësimin e infermierëve është një dështim i hapur. Më tej ai bën me dije se infermierët shprehen skeptikë mbi transparencën e këtij sistemi dhe sqaron se ana praktike, që është baza e Infermierisë nuk është cilësuar në asnjë nga pikat apo kriteret e përzgjedhjes. Gjithashtu Jaçaj thekson se deri më tani punësimet e infermierëve janë bërë përmes ngjyrimit politik, me mik apo dhe me lekë e shprehet se 2-3 javë nuk mjaftojnë për të shqyrtuar rreth 3500 dosje të aplikantëve të interesuar.

Chi është mendimi juaj si drejtues i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë mbi punësimin e infermierëve nëpërmjet portalit "Infermierë për Shqipërinë"?

Portali, në këtë kohë që po kalon shëndetësia në vend dhe sidomos infermierët, nuk është zgjidhja e duhur për punësim. Një portal që në lançimin e tij fton të gjithë administratën e punësuar dhe jo profesionistët që janë në kërkim të punës është turp. Një portal që hapet pa pasur një bazë drejtuesi si ekipin e përzgjedhjes së dosjeve të fituesve apo dhe të testimit se kuptoj si mund të lançohej. Dhe një portal që nuk është informues dhe sqarues për ata që janë në kërkim të një pune vështirë të funksionojë.

Sa e besueshme është kjo mënyrë për ju si infermierë?

Është e vështirë të thuhet që do të jetë i besueshëm! E para se ishte i nxituar dhe ata që e lançuan janë akoma të papërgatitur për vazhdimësinë e tij. E dyta, ne e kemi theksuar që më tepër do të jetë si një orientim për ata që kërkojnë punë se ku ka vende pune të lira dhe sa vende pune ka,

drejta.

A mendoni se është një proces transparent, ku fitojnë më të mirët bazuar në meritokraci dhe aftësi?

Nëse doni të vërtetën, jo vetëm unë, por të gjithë infermierët si ata që kanë aplikuar dhe ata që janë tashmë në punë janë shumë skeptikë që ky portal do të jetë transparent, e kjo jo vetëm në përzgjedhjen e personave që e meritojnë, por edhe në

portalit "Infermierë për Shqipërinë"?

Çuditërisht prej kohësh infermierët kanë qenë në kërkim të një vendi pune dhe gjithmonë u thuhej: "s'ka vende të lira, lini dokumentet pasi kur të ketë do ju njoftojmë". Dhe në momentin kur bëhet lançimi i portalit dalin që janë 420 vende të lira pune? Edhe pse ministria deklaroi 3434 aplikantë, në të vërtetë ka pasur mbi



jet e aplikantëve?

Sigurisht që nuk është kohë e mjaftueshme për asnjë aplikant. Nuk mjaftojnë 2-3 javë për të përzgjedhur dosjet, sidomos kur janë rreth 3500 të tilla. Vetëm për t'i lexuar duhet më tepër kohë, e jo më t'i përzgjedhësh drejt sipas meritokracisë dhe jo sipas mënyrave të tjera, siç ka funksionuar deri më sot (përmes ngjyrimit politik, me mik apo dhe me lekë). Ky është realiteti në vendin tonë!

Në diskutimet që keni organizuar me infermierët, a ka pasur ankesa në lidhje me ndonjë problem

“

"Sot të gjithë po i blejnë si licencën e ushtrimit të profesionit, si kualifikimet, ashtu edhe certifikatat e mbrojtjes së gjuhës. Ana praktike, që është baza e infermierisë nuk është cilësuar në asnjë nga pikat apo kriteret e përzgjedhjes".

teknik të portalit, çka mund të ketë penalizuar kandidatin?

Portali është një dështim i hapur që pa filluar edhe pse nuk pranohet nga ata që e hapën. Një portal që u bllokua disa herë gjatë aplikimit të infermierëve. E më pas rezultoi që për shkak të kësaj avarie, u kërkuar që dokumentet të mos ngarkohen në portal, por të dërgohen dorazi në ministri. Thëksoj faktin që këtë informacion nuk e dini në të gjithë aplikantët dhe për më keq u la një afat kohor prej 3 ditësh për këtë gjë. Infermierët me vendbanim në Tiranë mund t'i sillnin dokumentet, por një nga Kukësi apo Saranda, nuk kishte kohë të mjaftueshme për të ardhur deri në Ministrinë e Shëndetësisë.

Në portal u njoftua se në datën 15 mars do të shpallehin fituesit e fazës së parë, por deri më tani nuk janë publikuar ende emrat. A keni kërkuar informacion se pse ndodhi kjo shqyrtje?

U nxorën disa emra fitues të përzgjedhjes në bazë të dosjeve dhe u tha që një pjesë ka probleme me dosjen dhe u la prapë një afat kohor për të çuar dokumentacionin që u mungon dhe sërish asgjë. Në datën 15 mars do shpallehin fituesit e fazës së parë, në bazë të përzgjedhjes së dosjeve dhe do caktohej dita dhe vendi për testimin, që do ishte faza e dytë. Por edhe pse ka kaluar data 15, nuk ka asnjë listë fituesish dhe asnjë njoftim pse po vonon dhe çfarë do ndodh. Nuk i jepet informacion asnjë personi që interesohet në ministri.



Kreu i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, Elson Jaçaj

sesa do t'u krijojë mundësi punësimi profesionistëve që janë në kërkim të punës. Kur u hap portali "Infermierë për Shqipërinë", do donim të mësonim me kë grup interesi janë konsultuar ministria dhe të tjerët për efikasitetin e këtij portali? Pra, a janë takuar me përfaqësues të shoqatave, me Urdhrin e Infermierit, me Fakultetet e Infermierisë; pasi në ngritjen e pyetjeve apo dhe në testimin teorik apo praktik të infermierëve duhen profesionistët. Dhe nuk dihet kush do të bëjë përzgjedhjen dhe sa transparent do të jenë në dhënien e rezultateve të

vazhdimësinë e tij. Kjo sepse si mund të bësh përzgjedhjen e një personi mbi dosjen që dorëzon kur sot të gjithë po i blejnë si licencën e ushtrimit të profesionit, si kualifikimet, ashtu dhe certifikatat e mbrojtjes së gjuhës. Dhe për më tepër, dihet që infermiera është një profesion më tepër praktik se teorik dhe në testim dhe përzgjedhje, ana praktike që është baza e infermierisë nuk është cilësuar në asnjë nga pikat apo kriteret e përzgjedhjes.

Sipas informacione tuaja, sa vetë kanë aplikuar dhe sa prej tyre do të përzgjidhen nëpërmjet

3500 aplikime. Gjithashtu, një numër i madh të interesuarish nuk ishin të informuar se si të aplikojnë dhe sa kohë kishin në dispozicion.

Pra, numri i vendeve të lira të shpallura në portal nuk është i mjaftueshëm, krahasuar me numrin e infermierëve të papunë?

Janë mbi 3500 aplikime për 420 vende të lira dhe kuptohet sa është akoma numri i të papunëve në vend, pa llogaritur faktin që çdo vit mbarojnë infermierinë dhe licencohen me qindra infermierë të tjerë.

A është e mjaftueshme koha për të shqyrtuar dosjet



Foto ilustruese

Kreu i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë tregon se UISH nuk po i shërben kësaj kategorie

"Infermierët janë dhunuar fizikisht në krye të detyrës"

"Arsyet që i detyrojnë të largohen nga Shqipëria"

tonë, edhe pse një infermier paguhet sa një sanitare, shpesh më pak, dhe pse punon në kushte të vështira, nën një tryzni dhe presion gjatë gjithë kohës dhe shërben me gjithë zemër, prapë mbetet thjesht një "kafshë" pune për punëdhënësit.

Si paraqiten kushtet e punës për infermierët? A janë të kënaqshme?

Fatkeqësisht në Shqipëri edhe ambienti i punës është i pasigurt për infermierët, si nga ana higjienike edhe nga ana fizike. Theksoj se nga ana higjienike, infermierët punojnë në një ambient gjithë infeksione, pa doreza, pa maska e të pambrojtur. Në këtë mënyrë rrezikohet jeta e infermierit dhe pacientit. Ndërsa janë të pasigurt fizikisht, pasi kemi parë shumë raste që disa infermierë, sidomos në urgjencë, janë dhunuar fizikisht nga familjarët agresorë apo dhe pacientët pasi infermierit është kontakti i parë me pacientin.

Ju thatë që shpesh ushrohet dhunë fizike ndaj infermierëve. Pse ndodh diçka e tillë?

Kur dikush vjen në spital (sipas publicitetit që bëhet rëndom nëpër media e kudo që shëndetësia tek ne është falas dhe nuk mungon asgjë) në momentin që një pacient përballtet me realitetin e spitaleve dhe qendrave shëndetësore në vend kërkon përgjigje nga infermieri. Shpesh, shëndetësia te ne është një fasadë e bukur nga jashtë, por që brenda është akoma e kohës së Luftës së Dytë Botërore si në hoteleri dhe në shërbim medikamentoz. Fakti që ka mungesa dhe s'ka shërbim për çka një pacient ka nevojë, nuk është faj i infermierëve. Por duke qenë se infermierët janë të parët në kontakt me pacientin dhe familjarin, sigurisht që të parit që do i "shfryhen" është infermieri (me të drejtë për çka kërkojnë, por jo tek personi i duhur).

Sa vlerësohet një infermier në Shqipëri?

Një tjetër problem që hasin infermierët e që po iu zbeh dëshirën për të punuar në Shqipëri është diskriminimi profesional. Kjo pasi si nga ministria, edhe



Foto ilustruese

nga administratat ku punojnë, nuk janë shumë të vlerësuar profesionalisht. Edhe pse sot një infermier mbaron 5 vite fakultet po aq sa një mjek, edhe pse bën trajnime të vazhdueshme tek qendra e edukimit në vazhdim për rritje profesionale dhe janë vërtet të aftë dhe shumë të zotë, akoma është një frymë diskriminimi që qarkullon prej kohësh. Kjo vjen nga drejtues të ndryshëm, të cilët këtë negativitet shpesh e transmetojnë edhe tek pacientët, të cilët vijnë me atë lloj paragjykimi, por që fatmirësisht kur shikojnë punën dhe përkushtimin e infermierëve e thonë me plot gojë: "Bravo jeni me të vërtetë për t'u përgëzuar për çdo gjë që bëni".

Pse po largohen infermierët drejt vendeve perëndimore për të ushtruar profesionin e tyre?

Me të drejtë infermierët largohen nga Shqipëria, pasi është i vetmi vend që nuk di ta vlerësojë këtë profesion. Ndërkohë që e gjithë Europa e më gjerë po i kërkojnë, po i vlerësojnë, po i paguajnë mirë duke u siguruar shumë kushte, si për ta dhe për familjet e tyre. Ndërsa në Shqipëri është e kundërta; dalin shumë infermierë nga Fakultetet e Infermierisë në vend, gjë që çon në një numër të madh infermierësh të diplomuar çdo vit

dhe fatkeqësisht vendi ynë ofron pak vende pune për ta. Kështu që një nga arsyet kryesore të largimit nga vendi, është pamundësia e gjetjes së një vendi pune në Shqipëri.

A është një faktor ndikues edhe paga?

Një tjetër arsye e largimit të infermierëve nga Shqipëria, është edhe paga e ulët që marrin, pavarësisht se mund të bësh master e çdo lloj kualifikimi tjetër, nuk merr as rritje page, as rritje profesionale. Fatkeqësisht Shqipëria është këthyer në një vend që po vret çdo shpresë për çdo lloj moshe dhe çdo dëshirë për të punuar dhe kontribuar në vend.

Sa mbështetje gjëjnë infermierët për zgjidhjen e problematikave të tyre të Urdhrit të Infermierit?

Një shqetësim tjetër për infermierët është edhe institucioni i Urdhrit të Infermierit, i cili në 10 vjet nuk ka bërë asgjë për infermierët si kur janë dhunuar, si kur janë hequr padrejtësisht nga puna pa asnjë motivacion. Një urdhër që udhëhiqet prej 3 mandatesh po nga i njëjti person e ku nuk janë zhvilluar zgjedhje të drejta asnjëherë. Çdo tarifë e paguar nga infermierët në drejtim të këtij institucioni nuk është këthyer në shërbim asnjëherë. Çdo urdhër tjetër cakton datën e zgjedhjeve, shpall kandi-

datën e bën zgjedhje dhe çdo 4 vjet e më tej vendos dikë që shpalojë një program në të mirë të profesionit, ndërsa me infermierët nuk ndodh kështu.

Cilat janë disa nga problematikat që ju si shoqatë keni evidencuar në fakultetet e Infermierisë?

Vendi ynë ka shumë fakultete infermierie dhe nuk kanë një kurrikulë të unifikuar, po çdo fakultet ka kurrikulën e vet dhe nxjerr infermierë sipas modelit të tij, pra nuk dalin të njëjtë infermierë të përgatitur. Nuk i japim dot shpjegim faktit se pse duhet që fakultetet e infermierisë të drejtohen nga mjekë dhe të kenë kaq shumë lëndë mjekësore kur infermieri nuk i aplikon ato kur del në punë dhe pse ka kaq pak orë praktike në fakultete kur praktika është baza e infermierisë.

A është i mjaftueshëm staffi i infermierëve në spitale apo qendra shëndetësore?

E dhimbshme është që jemi akoma në tranzicion në këtë pikë, por më e dhimbshme është kur të kuptohet që jemi në një krizë për staf shëndetësor, për infermierë dhe mjekë. Kjo pritet të ndodhë pas jo shumë kohësh, pasi të gjithë po largohen dhe jo vetëm të rinj, por edhe profesionistë me përvojë pune. Pritet të shohim ku do të jemi më pas.

“

"Shëndetësia te ne është një fasadë e bukur nga jashtë, por që brenda është akoma e kohës së Luftës së Dytë Botërore si në hoteleri dhe në shërbim medikamentoz".

“

"Fakti që ka mungesa dhe s'ka shërbim për çka një pacient ka nevojë, nuk është faj i infermierëve".

Voltiza Duro

Kohët e fundit, mjekët e infermierët e diplomuar në vendin tonë po shohin vendet perëndimore si opsionet më të mira për të filluar një punë në profesion. Kjo kategori profesionistësh po largohen nga Shqipëria për një të ardhme më të mirë, me paga e standarde më të larta. Presidenti i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, Elson Jaçaj tregon për "Gazeta Shqiptare" se jo vetëm pagat e ulëta, por edhe kushtet e punës e diskriminimi profesional i detyrojnë infermierët të largohen nga vendi. Jaçaj më tej thekson se në shumë raste, infermierët janë dhunuar nga pacientët apo familjarët për mungesë shtrëtitësh apo ilaçesh e kjo jo për faj të infermierit.

Cilat janë disa prej problematikave që hasin sot infermierët në Shqipëri?

Infermierët sot kanë një sërë problematikash. Duke filluar që nga diskriminimi profesional. Në të gjithë botën, ashtu edhe tek ne, ata janë hallka më e rëndësishme e sistemit shëndetësor, pasi një mjek kalon shumë pak kohë me pacientin në krahasim me infermierin. Infermieri është kontakti i parë dhe i fundit me pacientin dhe është personi që vihet në shërbim të pacientit në të gjithë orarin e punës. Në vendin

SPIUNIMET NE DIKTATURE RAPORTET


Së shpejti libri më i ri "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist"

Vizita e Qosjes në Tiranë, Hadri: S'ka të drejtë, mirë ia bëtë, t'i ulet pak hunda

Raporti sekret i vitit 1974 për Ramiz Alinë, lidhur me vizitën në Shqipëri të profesorëve nga Kosova

Dashnor Kaloçi

Ashtu siç kemi parë edhe në disa nga kapitujt e tjerë paraardhës të këtij libri, në fillimin e viteve '70-të, Shqipërinë e vizituan shumë personalitete të arsimit, kulturës dhe letrave shqipe, gjë e cila bëhej në kuadrin e një protokollit të përbashkët që kishte nënshkruar Tirana zyrtare me Krahinën Autonome Socialiste të Kosovës. Në këtë kuadër, diku nga fillimi i verës së vitit 1974, në Shqipëri erdhën një delegacion nga Kosova, ku mes të tjerëve ishin edhe akademikë e historiani dhe i njohur, prof. dr. Ali Hadri, prof. dr. Skënder Riza si dhe pedagogu Emin Pllana. Gjatë qëndrimit të tyre afro njëmuor në Shqipëri, ata u shoqëruan nga Petrit Sinani, (punonjës i Institutit të Historisë), i cili sipas "rregullave" me të cilat funksiononte regjimi komunist i asaj kohe, ka përpiluar edhe një raport-informacion që më pas i është dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së dhe personalisht Ramiz Alisë, sekretarit përkatës të Komitetit Qendror të PPSH-së që mbulonete në rrugë partie, arsimit, artin, kulturën dhe propagandën.



Akademik, prof. dr. Ali Hadri

net e profesorëve të nderuar nga Kosova për kolegun e tyre, Qosja dhe gjithë vizitën e tyre në Shqipëri, na njeh raport-informacioni në fjalë të cilin po e publikojmë të plotë dhe pa asnjë shkurtime. Edhe pse në dokumentin në fjalë nuk ka asnjë shënim nga Ramiz Alia, duket se ai e ka parë atë, pasi aty ndodhet nënshkrimi (firma) e shefit të kabinetit të tij, Ilo Kodrës, i cili ka vënë shënimin e arkivimit të materialit.

RELACION

Mbi qëndrimin në vendin tonë të studiueëve kosovarë, profesor doktor Ali Hadri, profesor doktor Emin Riza, dhe të pedagogut Emin Pllana.

Në bazë të protokollit të bashkëpunimit mesimor shkencor midis Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe atij të Prishtinës, më



Rexhep Qosja, Ibrahim Rugova

DELEGACIONI

Diku nga fillimi i verës së vitit 1974, në Shqipëri erdhën një delegacion nga Kosova, ku mes të tjerëve ishin edhe akademikë e historiani dhe i njohur, prof. dr. Ali Hadri, prof. dr. Skënder Riza si dhe pedagogu Emin Pllana. Gjatë qëndrimit të tyre afro njëmuor në Shqipëri, ata u shoqëruan nga Petrit Sinani, (punonjës i Institutit të Historisë), i cili sipas "rregullave" me të cilat funksiononte regjimi komunist i asaj kohe, ka përpiluar edhe një raport-informacion që më pas i është dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së dhe personalisht Ramiz Alisë, sekretarit përkatës të Komitetit Qendror të PPSH-së që mbulonete në rrugë partie, arsimit, artin, kulturën dhe propagandën.

datën 2 qershor 1974 erdhën në vendin tonë një delegacion kosovar i kryesuar nga rektori i atij universiteti. Në këtë delegacion bënin pjesë edhe shokët e sipërshtënuar.

Më datën 2 qershor këta shokë u pritën në Han të Hotit nga Selami Pulaha - zëvendësrektor i këtij instituti.

Më datën 3.VI. '74 Ali Hadri, Skënder Riza bashkë me gruan e tij dhe Emin Pllanën u pritën në drejtori të këtij instituti, ku morën pjesë nga pala jonë, Stefanaq Pollo, Selami Pulaha, Niko Deçka, Stavri Naçi, Kristo Frashëri dhe Petrit Sinani.

Në këtë takim u bisedua për punën

kërkimore shkencore që do të bënin ata gjatë qëndrimit në Shqipëri.

Qëllimi i ardhjes së tyre në Shqipëri ishte shfrytëzimi i materialeve arkivale për periudha të ndryshme të historisë së popullit shqiptar.

Koha e qëndrimit ishte e ndryshme. Ali Hadri qëndroi prej datës



Prof. dr. Skënder Riza

2 deri më 28 qershor 1974, Skënder Riza nga 2 deri më 17 qershor dhe Emin Pllana nga 2 deri më 21 qershor 1974.

Gjatë kësaj periudhe ata punuan në Bibliotekën Kombëtare dhe në Institutin e Historisë, ku u shfrytëzuan, sipas rregullave të caktuara, materialet që nevojiteshin.

Prej datës 3 deri më 12 qershor Skënderi punoi 2-3 orë në ditë në Bibliotekën e Institutit të Historisë dhe kohën tjetër e kaloi, me të sho-



qen duke shëtitur dhe duke bërë vizita tek familja e Mehmet Lutit (gruaja e Skënderit, Mehmet Lutin e kishte djalë xhaxhai).

Në Institutin e Historisë, në Bibliotekën Kombëtare, punuan gjatë kësaj periudhe edhe Ali Hadri e Emin Pllana. Materialet që u shfrytëzuan ishin të periudhave të ndryshme. Aliu dhe Skënderi punuan për problemet e Lidhjes së Prizrenit, ndërsa Eminin për vitet 1900-1909. Nga ana jonë iu siguruan materialet e nevojshme. Skënderi dhe Aliu kishin në plan të mbanin edhe nga një ligjëratë. Skënderi e mbajti më 13 qershor 1974 me disa specialistë të historisë në institut, për të qartësuar disa mendime rreth historisë së 30 vjetshmit të fundit të shekullit të 19, për të cilën kishte përgatitur një monografi që së shpejti do ta dërgonte në shtyp.

Tema e ligjëratës së tij ishte "Roli i disa organizatave ndërkombe-tare në historinë shqiptare në bazë të burimeve osmane dhe angleze". Krahas këtij diskutimi, Skënderi dha një informacion për disa materialet që kishte zbuluar në arkivat e Londrës dhe Stambollit, për historinë e popullit shqiptar. Mendimet që i dhanë studiuesit tanë, ai i quajti mjaft me vlerë. Skënderi kishte dëshirë që para se të botonte ndonjë punim rreth historisë së Shqipërisë, ta diskutonte me specialistët tanë dhe të ndih-

monte me materialet arkivale me sa mundësi që kishte.

Më datën 28 qershor 1974, Ali Hadri mbajti ligjëratën e tij "Historiografia jugosllave mbi Lidhjen e Prizrenit", po në institut me specialist të historisë.

Krahas punës për kërkime arkivale, u bënë vizita në disa qytete të Shqipërisë. Më datën 6, Skënderi dha gruaja shkuan në Fier. Atje vizituan Apoloninë dhe në mesditë e po kësaj date shkuan në Vlorë, ku vizituan



Shtetorja në bronze e Ali Hadrit në Prishtinë

të gjithë në një kohë shumë të shkurtër". "Kjo gjë - thoshte ai, është në favorin tonë, se u dobësonte pozitaz serbëve dhe disa veglave të tyre".

Në Sarandë Skënderi dhe gruaja e tij mbetën shumë të kënaqur. Gjatë rrugës për në Sarandë, gruaja e tij shprehej me shumë admirim për ndryshimet e mëdha që janë bërë në Shqipëri.

Si Skënderi, edhe gruaja u shprehën me kënaqësi që i gjithë populli në Shqipëri punon dhe jeton në mënyrë të barabartë. "Tek ne - thoshte Skënderi - janë shumë të larta çmimet dhe nuk shikon njeri të futet në lokale si tek ju. Unë për shembull - tha ai - nuk kam shkuar ndonjëherë në Bozhun me gruan time, sepse është shtrenjtë".

Gruas së tij i bëri shumë përshlytje puna që bënin gratë. "Tek ne - tha ajo - gratë nuk punojnë, nuk ka punë". Fjalë shumë të mira thoshin për rregullin dhe qetësinë e madhe, si dhe për rregullin automobilistik.

Gruaja e Skënderit ka ikur nga Tirana për në Pejë në vitin 1946. Tiranën e njohte mirë dhe u çudit shumë kur pa gjithë ato ndryshime. "Nuk e gjej dot rrugën për tek shtëpia e axhës - thoshte - Tirana nuk ka qenë kështu".

varrezat e dëshmorëve dhe disa qendra të tjera. Në këto vizita i shoqëroi Petrit Sinani.

Më datën 7.VI.74, u nisën për në Sarandë, ku qëndruan deri më datën 10.VI.74. Po në këtë datë u nisën nga Saranda për në Berat. Këtu qëndruan vetëm disa orë. Në Berat, Skënderi takoi në praninë time, Zyra Berishën, pedagogo e gjuhës shqipe në filialin e U.S.H.T. që ndodhet në Berat. Zyra ishte nga Peja dhe në Shqipëri kishte ardhur para 13 vjetëve, Skënderi e kishte pasur nxënëse në Pejë.

Më datën 12 qershor, gruan e Skënderit e dërguan në Elbasan, ku qëndroi tri ditë tek vajza e xhaxhait, që ishte martuar atje me Skënderi....., shofer në Turizmin e Elbasanit.

Ditën që u nisën për në Sarandë, Skënderi dukej i mërzitur. Siç tha vetë, arsyeja ishte se një ditë më parë më 5.VI.74, u nis për në Sarandë rektori i Universitetit të Prishtinës dhe Skënderi donte të shkonte bashkë me të dhe gruan e tij. Mirëpo, sipas tij, rektori nuk pati dëshirë që të udhëtonte me Skënderin dhe gruan e tij, kjo gjë e kishte zëmëruar atë shumë, sa që shfaqti mendimin se "do të kthehemi sa më parë në Prishtinë", gjoja se kishte fëmijët vetëm dhe se djali i madh do të nisej për në Poloni. Me ndërhyrjen tonë u bind, dhe kur vajtëri në Sarandë, gjendja ndryshoi.

Gjatë bisedave në Sarandë Skënderi foli me urrejtje për Hasan Kaleshin, me të cilin kishte kontraktikta të thella. Këto kontraktikta, sipas tij e kishin bazën tek qëndrimi jo i drejtë i Hasanit ndaj historisë së popullit shqiptar Skënderi e quante atë "antishqiptar" dhe falsifikator të historisë, njeri që ishte shitur tek serbët. "Interesi ynë - thoshte ai - e do që të kemi unitet (fjala për Kosovën), dhe të marrim të gjithë drejtimin në Kosovë. Por ka edhe njerëz të tillë si Hasani, që mohojnë kombin". Kohët e fundit tha Skënderi, në Jugosllavi është kapur një grup antiparti. Pjesa më e madhe e këtij grupi të madh janë serbë, këta janë ngritur kundër Titos, por u zbluan dhe u kapën

Në Elbasan gruaja e tij qëndroi tri ditë dhe u gëzua shumë se ia plotësuan këtë dëshirë.

Skënderi shprehu mirënjohjen e thellë për pritjen e ngrohtë që i bëme ati dhe gruas, sepse "unë - tha ai - gruan do ta mbaja me shpenzimet e mijja personale, ndër- sa ju nuk më lejuat të harxhoja asnjë lek".

Me Emin Pllanën nuk pata rastin të shoqërohem vetëm për vetëm me të, veç 2-3 rasteve që u takuan në hotel "Dajti" dhe në institut. Emimi nuk lëvizti nga Tirana dhe gjithë kohën e kaloi duke punuar në bibliotekë.

Më Ali Hadrin u takuam më datën 3 qershor 1974, kur u bë pritja në institut dhe pastaj më 14.VI.1974 ditën që u nisën për në Sarandë. Duke shkuar për në Sarandë, qëndruam në Lukovë, ku



Rexhep Qosja dhe Dritëro Agolli




Jorgo Bulo dhe Rexhep Qosja

shkuam në një librari për të blerë një libër. Brenda në dyqan ishte një Kosovar, emigrant i ardhur në Shqipëri para 15-20 vjetëve që punon në Lushnje si mësues i historisë. Aliu bëri sikur nuk e pa, por ai. (Xheladin Perizaj quhej), i foli Aliut: "Si je Ali Hadri, a më njeh". "Më dukesh kosovar - tha Aliu - por nuk të mbaj mend". Aliu u duk se nuk kishte dëshirë që të bisedonte dhe doli menjëherë nga dyqani, sapo bleu librin.

Atë natë që arritën në Sarandë, ai u tregua i pakënaqur që nuk i dhamë në hotel një apartament, sepse sipas tij, dhoma që kishte, nuk ishte e përshtatshme për punë. "Në Prishtinë kam kushte shumë të mira, thoshte". Gjatë gjithë kohës që qëndruam në Sarandë, e përsëriti disa herë punën e apartamentit, duke thënë se "nuk më krijove kushte të mira për punë". Shkuam në Butrint y herë, njëherë në Delvinë, pamë një shfaqje të Estradës së Shtetit dhe një ditë në Borsh. Gjatë bisedimeve Aliu fliste shpesh për veten dhe kushtet e mira që kishte në Kosovë, për makinën e tij personale dhe për shtëpinë, që kishte ndër- tur në Pejë. Shprehte respekt ndaj studiuesve tanë historianë si dhe ndaj përgatitjes së studentëve në Shqipëri. "Atje në Prishtinë studentët nuk përgatiten shumë dhe pjesa më e madhe mbiten. Kushtet i kanë shumë të vështira, disa jetojnë në bodrume dhe nga njëherë dhe protestojnë", tha njëherë.

Nuk kishte simpati për Hasan Kaleshin dhe shprehu mendimin se ai duhet t'i shërbejë dikujt tjetër. Fliste për urrejtje dhe për Emin Pllanën. Lidhur me ligjëratën që mbajti Rexhep Qosja në Shqipëri dhe me diskutimet që u bënë rreth ligjëratës së tij nga studiuesit tanë, Aliu shprehu mendimin se Rexhepi nuk kishte të drejtë. "Shumë mirë ia bëne, Rexhepi ka nevojë t'i ulët pak hundat". Vlerësoi diskutimin e sh. Aleks Buda, Jorgo Bulon dhe Koço Bihiku. Aliu kishte dëshirë që punimet që bëhen tek ne, për periudhën e Luftës Nacional-Çlirimtare, t'i shihte edhe ai.

Ky diskutim lindi se Aliu, duke shfletuar librin "Brigada VI Sulmuese", në pjesën ku flitet për kalimin e kësaj brigade në tokat jugosllave, i ra në sy një paragraf ku thuhej nga autori, se "Ushtria Nacional-Çlirimtare shqiptare çliroi edhe disa toka të Jugosllavisë". Kjo tha ai është shumë e shtrembër dhe e papranueshme. "Unë e di - tha - se shoku Enver e përcaktonte këtë drejt, por autori ka bërë gabim". "Këtë e them, se atashu kultural, i Ambasatës Jugosllave në Tiranë, fatkeqësisht ose fatmirësisht është nga Gjakova dhe i lexon të gjitha materialet dhe krijohen keqkuptime në këtë drejtim". Në vijim të kësaj bisede Aliu tha: "Unë kam vërejtje edhe për historikun e



Elbasanit. Aty nuk flitet për djemtë kosovarë që kanë milituar në grupet komuniste, duhet të shënohen emrat e Fadil Hoxhës dhe Xhavit Nimanit". Për këtë arsye, më se dukej duhej t'i jepeshin Aliut: për të dhënë mendim, shkrimet që bëhen për Luftën Nacional-Çlirimtare. Fliste shumë për punën e tij dhe e quante veten si i vetmi historian, që ka dhënë punime të mirëfillta për trevën e Kosovës. Për ndryshimet që janë bërë në Shqipëri fliste shpesh dhe thoshte: "Të gjitha këto ndryshime janë veper e partisë me shokun Enver në krye. Shoku Enver dhe Partia juaj është shumë e fortë, ka kaluar

shumë furtuna: p.sh. në kohën e Koçi Xoxes kanë qenë situata shumë të vështira. Koçi ishte i poshtër, agjent i Rankoviçit. Unë i kam parë të gjitha dokumentet në Beograd, të lidhjes së Koçit me Rankoviçin". "Ai që nuk sheh ndryshimet që kanë ndodhur në Shqipëri gjatë këtyre 30 vjetëve, është njësoj si një njeri që nuk sheh pyllin që ka para syve, por shikon një dru të shtrembër midis këtij pylli të madh". Një ditë u interesua edhe për gjendjen ekonomike të shoferit, e pyeti atë se sa e ka pagën mujore dhe a i mjafton ajo jo. Tiranë, më 4.VII.1974 Shoqëruesi (Petrit Sinani)

Mosdekretimi i gjuhës, analisti: Vendimi motivohet nga opozita

Ligji për shqipen fuqizohet edhe pa firmën e Ivanov

Mosmiratimi nga Presidenca, çështje e përsëritur

Ligji për përdorimin e gjuhëve do të mund të hyjë në fuqi edhe pa nënshkrimin e presidentit Gjorge Ivanov. Ekspertët vlerësojnë se me nënshkrimin e kryetarit të Kuvendit dhe shpalljen e tij në Gazetën Zyrtare, presidenti do të gjendej ligjërisht para aktit të kryer. Nikolla Dujovski thekson se praktika të tilla ka pasur edhe më herët. "Do të ishte mirë që presidenti ta nënshkruante ligjin, sepse për atë është i detyruar dhe nuk ka të drejtë të mos e bëjë. Nuk është detyrë e tij të vlerësojë procedurën. Por përderisa e dimë se me cilin kemi punë, pres që të përsëritet ajo që ka ndodhur edhe më herët. Kur presidentët nuk kanë dekretuar ligje, mjafton që të kalojnë gjasthë ditë dhe me nënshkrimin e kryetarit të Kuvendit ligji i cili është votuar për herë të dytë të adresohet në Gazetën Zyrtare dhe me këtë të hyjë në fuqi. Pas kësaj mund të pasojnë iniciativat për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit", thotë analisti Nikolla Dujovski. Nga ana tjetër, analistët politikë vlerësojnë se vendimi i Ivanovit për mosdekretimin e ligjit është veprim i motivuar politik. Sipas



analistit Sefer Tahiri, vendimi i presidentit motivohet nga politika e pandryshueshme nacionaliste e VMRO-DPMNE-së. "Kjo parti e ka shumë të vështirë ta ndryshojë kursin dhe ideologjinë e saj, se në këtë shtet maqedonasit duhet të jenë bartës të sovranitetit dhe jo qytetarët, pra jo edhe

shqiptarët. Kjo qasje mendoj se ia vështirëson rikthimin e saj në pushtet. Mendoj se nuk pritet ndonjë veprim tjetër nga ky president, i cili në fakt nuk është president, por është vetëm një figurë dhe marionetë politike e VMRO-DPMNE-së. Presidenti i Maqedonisë është më i mirë kur nuk flet se sa kur

deklaron diçka", - vlerëson analisti tjetër Sefer Tahiri. Derisa shumica parlamentare nuk bën të ditur nëse kanë plan B në rast se Ivanov përfundimisht nuk nënshkruan ligjin, ekspertët këmbëngulin se shkeljet procedurale dhe jo kushtetutshmerinë e ligjit mund ta vlerësojë vetëm Gjykata Kushtetuese. Liderët aktin e Ivanovit e quajten qyqar, ndërsa ish-kryeministri Nikolla Gruevski veprimet e tij në miratimin e ligjit i arsyeoi me tentativa për ta penguar procedurën, siç e quajti ai, jokushtetuese. Kreu i Kuvendit nga ana tjetër ka përsëritur se rreth mënyrës për hyrjen e ligjit në fuqi akoma është duke u diskutuar. Ligji për përdorimin e gjuhëve u miratua më 11 janar, ndërsa më 17 janar Ivanov njoftoi mosdekretimin. Leximi i tretë u bë shumë ditë pas afatit 30-ditor sipas Rregullores së Kuvendit. Arsye për këtë sipas të parit të ligjvënësve ishte ideja që subjektet të unifikohen për veprim të logjikshëm. Ligji për përdorimin e gjuhëve për herë të dytë u miratua me 14 mars me 64 vota pa shqyrtuar asnjë nga 35 mijë amendamentet e VMRO-DPMNE-së.

REAGIMI



Katalonja, Puigdemont:

Pavarësia nuk është e vetmja zgjidhje

Ish-presidenti i Katalonjes, Carles Puigdemont, duket i dorëzuar në betejën për pavarësinë e rajonit autonom. Ai thotë se pavarësia tashmë nuk është zgjidhja e vetme dhe bën thirrje për dialog të ndërmjetësuar nga BE. "E gjithë ajo që mund të bëhet nga jashtë është favorizimi i një dialogu në interes të katalanasve, spanjollëve dhe të gjithë europianëve. Më mund të imagjinohet një zgjidhje pa një bisedim, që sheh pjesëmarrjen e një pale të tretë që mund të kryejë rolin e ndërmjetësuesit. Nuk kërkohet nga komuniteti evropian të mbështesë pavarësinë e Katalonjes, por të mbështesë të drejtat e qytetarëve dhe të politikave themelore". Kështu shprehur në një intervistë për mediat italiane, ish-lideri katalanas, Carles Puigdemont. "Më pyesin gjithnjë - bën me dije Puigdemont - nëse pavarësia është zgjidhja e vetme. Unë përgjigjem duke thënë se nuk është rruga e vetme. Jemi të gatshëm për të punuar edhe në modele të tjera për të arritur një marrëveshje". Gjithashtu ish-presidenti i Katalonjes thotë se modeli zviceran respekton diversitetin kulturor dhe gjuhësor si dhe tregon se bashkëjetesa është e mundshme. "Duhet pranuar tjetri si një subjekt politik, me të cilin duhet të dialogohet, pa linja të kuqe", shprehur Puigdemont duke nënvizuar se nuk ka arritur t'i tregojë Spanjës nevojën e bisedimeve. "Ata duhej të na njihnin si aktor politik dhe jo si subjekt kriminal", shton ai. Se cili do të jetë saktësisht roli i tij në të ardhmen, udhëheqësi katalanas përgjigjet: "Kjo varet. Nëse shteti spanjoll nuk vendos të kuptojë se duhet të fillojmë të flasim dhe të bëjmë politikë, nëse vazhdon me represionin, persekutimin gjyqësor; ndoshta do të duhet të dorëzohet në mërgim disa vjetra. Por nuk është dëshira ime, unë punoj për një zgjidhje politike me negociatë", përfundon Puigdemont.

Artikulli: Shqiptarëve s'u intereson çështja e emrit

Media greke: Lakmia për "Shqipërinë e madhe" rrezikon 'kokat' e Gruevskit dhe Zaevit

Pas miratimit të ligjit për gjuhët, mediat greke i kanë kushtuar një artikull situatës së tensionuar politike në Maqedoni. Në këtë shkrim thuhet se 'kokat' e Gruevskit dhe Zaevit janë të rrezikuara nga përplasjet brenda shtetit, por edhe nga çështja e emrit. Kështu, në artikullin e botuar në "voria.gr", vihet në dukje se shqiptarëve nuk u intereson fare çështja e emrit, pasi ata pretendojnë se një ditë do të jenë pjesë e "Shqipërisë së Madhe" dhe emri do të jetë i përkohshëm. Nga ana tjetër, me tone të forta dhe raciste pritet që të reagojnë sllavët, kundër kryeministrit Zaev, pasi ky i fundit po bën shumë lëshime në favor të shqiptarëve.



ARTIKULLI

"Lakmia" e madhe e shqiptarëve ka kërcënuar se Gruevski po vë lëkurën e tij në rrezik, nëse vazhdon të pengojë zyrtarizimin e gjuhës shqipe në Maqedoni. Por, duke pasur parasysh situatën sociale dhe politike në Ballkan, një kërcënim i tillë nuk mund të jetë vetëm një "fjalë e thënë", por mund të veprojë. Ka shumë dëshmi dhe "letra", që diplomacia greke nuk duket të luajë. Natyrisht, unë them se faktori shqiptar ka arsye

të forta që Shkupi të mbajë emrin derivat të "Maqedonisë". Interesi kryesor për shqiptarët në Shkup është pranimi në BE dhe NATO, në të cilat është vonuar për shkak të zgjidhjes së emrit. Ali Ahmeti, kreu i partisë më të madhe shqiptare, ka thënë me tone të ashpra se për procesin e bisedimeve Greqi-Shkup ai nuk do t'ia dijë fare, edhe nëse vendi do të quhej 'Disneyland'. Arsyeja e dytë për marrëdhëniet e tensionuara shqiptare dhe sllave në Shkup është dështimi i Marrëveshjes 'Gruevski' të Ohrit në 2001 për të përmirësuar marrëdhëniet e tyre. Kryeministri i tanishëm, Zoran Zaev po përpiqet të pajtohet me shqiptarët, por nuk dihet se si do të reagojnë sllavët nga tërheqjet e tij të fundit. Por, kreu i partisë tjetër shqiptare (PDSH) në Shkup, Meduth Thaçi, ka thënë: "Qeveria e Shkupit është nacionaliste dhe naziste", për shkak të politikës së ndjekur nga qeveria e Shkupit kundër shqiptarëve. Por më e rëndësishme dhe në interes të drejtë-përdrejtë për Greqinë ishte vazhdimi i deklaratës së tij: "Mendoj se është hera e fundit që them hapur se qëndrimi i shqiptarëve është në favor të qëndrimit grek. Lufta e Gruevskit dhe sllavëve për të ruajtur emrin Maqedoni, si vazhdimësi e një trashëgimie të lashtë, si dhe identiteti kombëtar, është lufta antishqiptare dhe antiheleniste. Nacionalizmi dhe nazizmi i kësaj qeverie janë në fakt antihelenike dhe antishqiptare". Argumenti i shqiptarëve të Shkupit në konfliktin e tyre me sllavët është se Shkupi nuk mund të quhet "Maqedoni", sepse shqiptarët nuk identifikohen në këtë mënyrë, shkruhet në një pjesë të artikullit grek.



Vuçiq: S'ka zgjidhje për Kosovën, nëse Prishtina nuk bën kompromis

Mediat serbe kanë vijuar të transmetojnë fjalimin e para dy ditëve të Presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjes së Kosovës. "Nëse Prishtina nuk dëshiron të bëjë kompromis, nuk do të ketë zgjidhje për Kosovën dhe pikë", tha dje presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, raporton gazeta "Novosti". "Ne do të vazhdojmë bisedimet me shqiptarët, në përpjekje për të zgjidhur problemet tona, pa marrë parasysh se asgjë nuk iu besoj, por ne nuk kemi zgjedhje tjetër", tha Vuçiq. Ai shtoi se në vazhdimin e bisedimeve me Prishtinën, më 23 mars shkon në Bruksel pa asnjë shpresë dhe se puna e tij është të mbrojë interesat e Serbisë. Thotë se është i gatshëm të degojë këdo që ia tregon një zgjedhje tjetër, me kusht që të dijë të gjitha rrethanat që lidhen me këtë çështje, përcjell "Telegrafi". Vuçiq përsëriti se në prill do të dalë me propozimin për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe thotë se si gjithmonë qëndron prapa asaj që ka thënë, por që gjithmonë do të mbajë për vete mundësinë për të përshpejtuar ose ngadalësuar diçka, për shkak të specifikave të situatës politike të jashtme. "Është detyrë e imja t'u them njerëzve se çfarë mendoj për gjithçka që po ndodh. Askënd nuk e gënjej, edhe fuqive më të mëdha u them çfarë mendoj, prandaj më respektojnë personalisht si kryetar i Serbisë në të gjithë botën, sepse e dinë që gjithmonë përfaqësoj interesat e Serbisë", tha Vuçiq, duke theksuar se "qoftë vetëm ose me të gjithë juve, unë do të vazhdoj me çdo kusht, kurse popullit i mbetet ta pranojë, ose jo". Duke iu përgjigjur pyetjeve nëse do të ketë një referendum për çështjen e Kosovës, Vuçiq tha se çdo ndryshim në Kushtetutë e kërkon këtë dhe se populli do të vendosë për gjithçka. "Nuk do të jem i pakënaqur nëse do të detyrohem të hap rrugë, sepse detyrë e imja është të bëj atë që mendoj se është më e mira për Serbinë e jo të mendoj se si t'i shmangem popullit", tha presidenti serb.




VETITË KURATIVE TË ANTIOKSIDANTIT



Ylli Merja:
Propolisi i
bletës, antibiotik
i çmuar i natyrës

REKOMANDIMET



10 këshilla të
vlefshme për të
eliminuar rrezikun
nga infeksionet

Bajram Balliu:

Mjeku obstetër-
gjinekolog: Ja
komplikacionet
pas ndërprerjes
së shtatzënisë



Alarmi, medikamentet për abort, të palicensuara në vendin tonë

"Farmacistë të papërgjegjshëm
i japin pa rekomandimin e mjekut"

• Largoni toksinat nga organizmi me çajin e kulumbriës. Konsumoni kungujt e njomë, më pak rrezik nga sulmet në zemër

Mjeku obstetër-gjinekolog: Ja komplikacionet pas ndërprerjes së shtatzënisë

Bajram Balliu:

Alarmi, medikamentet për abort, të palicencuara në vendin tonë

"Farmacistë të papërgjegjshëm i japin pa rekomandimin e mjekut"

Voltiza Duro

A borti është procesi që kryhet për ndërprerjen e shtatzënisë para moshës së barrës prej 22 javësh. Në vendin tonë, sipas statistikave kryhen deri në 17.2 aborte për 100 lindje. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku obstetër-gjinekolog Bajram Balliu tregon se medikamentet që merren për ndërprerjen e shtatzënisë, jepen nga shumë farmacistë të papërgjegjshëm pa këshillën e mjekut. Sipas mjekut, këto medikamente që hyjnë në vendin tonë janë të palicencuara e në shumë raste jeta e gruas ka qenë në rrezik për shkak të hemorragjisë së theksuar. Balliu më tej tregon të gjitha komplikacionet që vijnë si pasojë e abortit e u bën thirrje gjithë femrave që duan të kryejnë një procedurë të tillë, që të drejtohen pranë materniteteve apo klinikave të licencuara e të bëjnë paraprakisht të gjitha ekzaminimet e nevojshme.

Sa është numri i aborteve në Shqipëri?

Aborti është ndërprerja e shtatzënisë përpara moshës së barrës 22 javë, i cili mund të jetë spontan apo me dëshirën e pacientes dhe partnerit të saj. Në vendin tonë aborti është i lejuar që nga viti 1992 e ky proces kryhet nga një mjek obstetër-

gjinekolog, sipas ligjit mbi abortin. Aktualisht në Shqipëri kryhen 7.3-17.2 aborte për 100 lindje.

Cilat janë ekzaminimet që kryhen paraprakisht nga mjeku përgjegjës?

Mjeku që merr në ngarkim çështjen duhet të bëjë përcaktimin e saktë të moshës së barrës, edhe nëse pacientja dëshiron ta abortojë. Kësaj të fundit i bëhet me dije procedura dhe njihet me ligjin mbi abortin. Më tej, pas një jave, merret anamneza, e kryhet ekzaminimi objektiv dhe ekzaminimet e

medikamentoze kryhet vetëm nëse moshja e barrës është më pak se 49 ditë. Duhet theksuar se në praktikën e përditshme, hasim shpesh komplikacione të shumta nga përdorimi i këtyre medikamenteve (të palicencuara në vendin tonë).

Këto medikamente a jepen me këshillën e mjekut apo vetëm nga farmacisti?

Medikamentet për abort merren në farmaci pa këshillën e mjekut dhe përdoren. Pastaj pacientja vjen në maternitetin tonë



Mjeku obstetër gjinekolog, Bajram Balliu

Cilat janë kundërrindikacionet për përdorimin e medikamenteve për abort?

Theksoj edhe njëherë që vetëm mjeku obstetër-gjinekolog ka për detyrë që të përcaktojë nëse aborti mund të kryhet me medikamente, kuptohet duke qenë pacientja nën mbikëqyrjen e mjekut. Kundërrindikacionet janë: sëmundjet e rënda kardiovaskulare, të mëlçisë, veshkave dhe mushkërive, anemia (Hb nën 10), shtatzënia jashtë mitre, alergjitë, fibromyoma e

instrumentale. Anestezia mund të bëhet lokale ose endovenoze. Disa orë përpara ndërhyrjes, mund të jepet brufen 400-800 mg dhe diazepam 2.5 mg.

Cilat janë komplikacionet që mund të shfaqen nga aborti?

Injektimi lokal i lidokainës në enët e gjakut të qafës së mitrës mund të shkaktojë vdekje. Gjithashtu mund të shfaqen edhe komplikacione nga anestezia endovenoze, hemorragji në sasi të madhe si pasojë e rënies së fuqisë tkurrëse të mitrës. Pacientja mund të pësojë edhe shock cervical, humbje të vetëdijes nga stimulimi për të hapur qafën e mitrës, si dhe mund të preket nga triada postabort që konsiston në dhimbje, hemorragji dhe ethe. Dëmtimet apo çarjet e qafës së mitrës, të vetë mitrës, si dhe hemorragjitë në sasi shumë të madhe mund të jenë komplikacione pas abortit. Femra që ka kryer këtë proces mund të ketë dëmtime të zorrëve dhe vezikës urinare nga çarja e mitrës si dhe mund të preket nga endometriti, infeksion i mitrës. Komplikacion i vonshëm mund të jetë edhe steriliteti ose pamundësia për të ngehur shtatzënë.

Çfarë u rekomandoni pacienteve që dëshirojnë të ndërprejnë shtatzëninë?

Pavarësisht debatare pro dhe kundër abortit, unë do t'u rekomandoja pacienteve që pasi ta marrin vendimin për kryerjen e abortit, të drejtohen vetëm te mjeku obstetër-gjinekolog dhe në maternitetet ose klinikat e licencuara, të kryejnë ekzaminimet e nevojshme dhe t'i nënshtrohen procedurës me qëllim që komplikacionet të jenë sa më të vogla dhe jeta e pacientes të jetë e sigurt.



nevojshme laboratorike (gjak komplet, grupi i gjakut, koha e protrombinës, kulturë e sekrecioneve vaginale etj.) sipas protokollit.

Cilat janë metodat e kryerjes së abortit?

Ka dy mënyra për të kryer abortin që janë metoda medikamentoze dhe ajo kirurgjikale (me vacuum aspirator, kyretazh). Metoda

me hemorragji të shprehur. Kemi pasur raste kur është rrezikuar jeta e gruas nga përdorimi i këtyre kokrrave. Ka farmacistë të papërgjegjshëm që rekomandojnë përdorimin e këtyre kokrrave. Dua t'u bëj thirrje pacienteve që të mos marrin asnjëherë ilaçe në farmaci pa u konsultuar me mjekun.

përmasave të mëdha, hemorragjia uterine e padiagnostikuar etj.

Po metodat kirurgjikale që përdoren cilat janë?

Në barrat e vogla nuk kërkohet përgatitje e veçantë, kurse në barrat mbi 12 javë, patjetër duhet përgatitur qafa e mitrës me medikamente si prostaglandina, laminaria etj., dhe pastaj të kryhet zbrazja

Voltiza Duro

Propolisi i bletës është një antibiotik i çmuar natyral, antiviral, anti-inflamator, antimykotik, antibakterial, antioksidant, imunostimulant, antiseptik e antiparazitarr. Ky produkt i bletës është një nga medikamentet më të vjetra e më të njohura nga njerëzimi. Propolis është një përzjerje substancash regjese, gome e balsamike që bletët e mbledhin në sythet apo në lëkurën e disa bimëve, duke e transformuar, me anë të sekrecioneve të tyre në një produkt të veçantë. Në përbërjen kimike të propolisit bëjnë pjesë rrëshira, balsami, dylli, vajrat eterikë, poleni dhe lëndë organike dhe minerale. Në të gjitha lëndët që përmban propolisi më të rëndësishmet janë flavonet, ku në 50 që janë zbuluar te ky medikament, 19 prej tyre janë bioaktive që luajnë efektin terapeutik të propolisit. Ndërsa në hirin e këtij të fundit, janë gjetur lëndët minerale si hekur, magnezi, kaliumi, alumini, ndërsa ndër vitaminat numërohen vitamina B1, PP, provitamina A.

Efektet kurative

Propolisi rekomandohet të përdoret kundër diabetit; ftohjes; kisteve; alergjive; infeksioneve të gojës, veshkave apo tëmthit. Gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në kurimin e koleritit, ulçerës, mykut dhe krimbave të zorrëve, por gjen përdorim edhe në trajtimin e hazmatikës së fyturës dhe reumatizms. Ky medikament ndihmon në kurimin e disa sëmundjeve të tjera si astma, spondilartroza, parkinsoni apo hernia diskale. Propolisi është një kombinim komponentësh me natyrë aromatike e fenolike, të pasura me një numër të madh substancash të shumëllojshme mes tyre. E veçanta e këtij medikamenti qëndron në pasurinë e madhe të flavonoideve, falë të cilave propolisi siguron veçorinë antimikrobike. Sipas disa studimeve, rreth 1/3 e fraksioneve të propolisit të tretshëm në alkool etilik, ka natyrë flavonoide, mes të cilave është identifikuar galangina dhe pinoembrina. Këto të fundit kanë efekte shumë të mira bakteriostatike që përfaqëson veprimin antihelmues.

Vetitë bakteriostatike dhe baktericide

Ekspertime të panumërta kanë dëshmuar se si drejtpërdrejt, ashtu edhe në të kundërt, kapaciteti i propolisit në solutione alkalike me përqindje 10-20% vepron në mënyrë efektive për të ndihmuar në ndalimin e zhvillimit të baktereve të ndryshme.

Veçoritë fungicide e antivirale

Preparatet me bazë propolisin, kanë rezultuar veçanërisht aktive kundër infeksioneve candida, tricollit dhe microspori, të cilët janë në gjendje të pro-



Mjeku popullor: Vetitë kurative të antioksidantit të fuqishëm, ja si ta përdorni

YLLI MERJA: Propolisi i bletës, antibiotik i çmuar i natyrës "Lufton diabetin, infeksionet e alergjitë"



Mjeku popullor, Ylli Merja

vokojnë sëmundje të shumta parazitare mbi njeriun apo dhe kafshën. Veprime të tilla i detyrohen acidit kafeik, pinoembrinës dhe benzi-p-cumarolo. Gjithashtu, propolisi paraqet një veprimtar parandalues në kufijtë e disa llojeve herpes, corona virus dhe në rreth 10 lloje të infeksioneve të ndryshme. Vlen të theksohet fakti, se ky medikament është përdorur gjithmonë edhe për rigjenerimin e indeve në rast plagosjeje. Në rastet kur përdoret ky medikament, është fuqizuar njëkohësisht edhe veprimtaria e vaksinave, si ato kundër tifos.

Antioksidant i fuqishëm

Propolisi i përdorur nga goja përmirëson sekrecionet e lëngjeve

gastrite, e shërben si një diuretik e madje favorizon asimilimin e vitaminës C. Ndërkaq, falë veprimt të flavonoideve që përbëjnë të ashtuquajturin "faktor P", propolisi luan një rol mbrojtës për kapilarët e gjakut.

Përdorimi i medikamentit

Mbi plagën e porsakrijuar, hidhet propolis 4-5 herë brenda një ore, e më tej çdo 3-4 orë hidhen 10-12 pika. Ky propolis krijon një shtresë të hollë mbrojtëse midis plagës dhe mikrobeve të ambientit. Pas kësaj periudhe, propolisi shfaq vet-

Propolisi është një kombinim komponentësh me natyrë aromatike e fenolike, të pasura me një numër të madh substancash të shumëllojshme mes tyre. E veçanta e këtij medikamenti qëndron në pasurinë e madhe të flavonoideve, falë të cilave propolisi siguron veçorinë antimikrobike. Sipas disa studimeve, rreth 1/3 e fraksioneve të propolisit të tretshëm në alkool etilik, ka natyrë flavonoide, mes të cilave është identifikuar galangina.

inë cikatrizuese, pra mbyll plagën dhe rigjeneron lëkurën. Kur plaga ka filluar të mbyllet mirë, atëherë ai hidhet mbi plagë 2-3 herë në ditë pas çdo pastrimi. Ndërsa për qetësimin e kollës, acarimit të bagjave apo kundër mykut, propolisi pihet 3-4 herë në ditë nga 5-6 pika për fëmijët deri në 7-8 vjeç dhe 10-12 pika për të rriturit. Po kështu përdoret propolisi edhe nga njerëzit e zakonshëm, dhe mund të quhet me të drejtë si një plotësues shumë i mirë në dietën ushqimore të përditshme.



10



këshilla të vlefshme për të eliminuar rrezikun nga infeksionet

Ka disa mënyra të provuara për të mbajtur veten të shëndetshëm e larg mikrobeve, por egzistojnë disa forma të tjera praktike për të shpëtuar nga infeksionet. Lëkura juaj vepron si një pengesë e natyrshme kundër mikrobeve të dëmshme që shkaktojnë infeksione, por në momentin që gjejnë rrugë alternative për të hyrë në organizëm, mund të përbëjnë rrezik. Më poshtë po japim 10 këshilla të vlefshme për të zvogëluar rrezikun e prekjes nga infeksionet.

Lani duart shpesh dhe mirë

Mikrobet mund të jetojnë në sipërfaqe inerte nga disa minuta deri në disa muaj, në varësi të llojit dhe mjedisit. Këto mikrobe që shkaktojnë sëmundje mund të jetojnë edhe në tastierën e kompjuterit tuaj. Çuditërisht, shumica dërrmuese e njerëzve nuk e dinë mënyrën më të mirë për të larë duart në mënyrë efektive. Kështu që rekomandohet larje e plotë dhe e fuqishme me sapun dhe ujë për të paktën 20 sekonda, pasuar me tharjen e dorës me një peshqir.

Kujdes me sendet personale

Furça dhëmbësh, peshqirë, brisqe, shami dhe gërshtë mund të jenë burime të agjentëve infektivë (baktere, viruse dhe kërpudha). Kujdes me sendet tuaja personale, mos i ndani me askënd pasi në këtë mënyrë mund të jeni të predispozuar që të prekeni nga infeksione të ndryshme.

Mbuloni gojën kur keni kollë ose teshtini

Higjiena e mirë personale përfshin jo vetëm pastërtinë, por edhe praktikën e vjetër të mbulimit të gojës kur ju kolliteni apo teshtini. Për shumicën e infeksioneve, mikrobet që shkaktojnë sëmundje mund të fillojnë të rriten para shfaqjes së simptomave, kështu që kollitja apo teshtitja mund t'i përhapë këto mikrobe në ajër. Rekomandimi është që të mbuloni gojën sa herë që teshtini apo kolliteni.

Vaksionohuni

Sistemi juaj imunitar është projektuar që të ketë një "kujtësë" të infeksioneve të mëparshme. Kur trupi juaj ndesh një mikrob që ka shkakuar më parë një infeksion, rrit prodhimin e qelizave të bardha të gjakut dhe antitropave për të parandaluar infeksionin për herë të dytë. Megjithatë, duke u vaksinuar, ju rrisni kështu mbrojtjen ndaj infeksionit. Marrja e imunizimit që ju nevojitet do t'ju mbrojë juve dhe ata që janë përreth jush.

Hani shëndetshëm

Sëmundjet që vijnë nga ushqimi shpesh shfaqen nga përgatitja e ushqimit jo të mirë dhe zakonet e këqija të ngrënies. Mikrobet "lulëzojnë" pothuajse në të gjitha produktet ushqimore, dhe më shumë në ushqime të lëna në temperaturën e dhomës. Ftohja ngadalëson ose ndalon rritjen e mikrobeve më të mëdha. Kështu që mbani vendin ku gatuarit të

pastër, dhe lani të gjitha frutat e ushqimit jo të mirë dhe zakonet e këqija të ngrënies. Mikrobet "lulëzojnë" pothuajse në të gjitha produktet ushqimore, dhe më shumë në ushqime të lëna në temperaturën e dhomës. Ftohja ngadalëson ose ndalon rritjen e mikrobeve më të mëdha. Kështu që mbani vendin ku gatuarit të

pastër, dhe lani të gjitha frutat e ushqimit jo të mirë dhe zakonet e këqija të ngrënies. Mikrobet "lulëzojnë" pothuajse në të gjitha produktet ushqimore, dhe më shumë në ushqime të lëna në temperaturën e dhomës. Ftohja ngadalëson ose ndalon rritjen e mikrobeve më të mëdha. Kështu që mbani vendin ku gatuarit të

Kujdes gjatë udhëtimit

Sëmundjet infektive mund të merren lehtësisht gjatë udhëtimit. Nëse destinacioni juaj i udhëtimit është ai ku uji mund të mos jetë fort i pastër, sigurohuni

që të përdorni një burim të sigurt të ujit, si ai në shishe. Hani ushqime që janë gatuar mirë dhe shmangni perimet dhe frutat e papërpunuara. Përfundimisht, sigurohuni që të përditësoni të gjitha vaksinat që këshillohen ose kërkohen për destinacionin tuaj të udhëtimit.

Mardhënie seksuale të sigurta

Sëmundjet seksuale transmetueshme janë ndoshta sëmundjet infektive më të parandalueshme. Duke kryer mardhënie të mbrojtura, transferimi i baktereve ose viruseve infektive nga një person në tjetrin mund të parandalohet.

Duart larg fytyrës

Jo vetëm që është një tabu sociale, por prekja e hundës çon në përhapjen e një numri të infeksioneve. Shikoni përreth, dhe do të vini re se sa njerëz kanë duart e tyre pranë fytyrave të tyre. Shumë mikrobe preferojnë mjedisin e ngrohtë, me lagështi brenda hundës, si dhe sipërfaqet e tjera të mbuluara me mukozë, siç janë sytë dhe gojët. Infeksionet mund të parandalohen lehtësisht duke shmangur prekjen e këtyre zonave.

Kujdes me kafshët

Infeksionet që mund të përhapen nga kafshët tek njerëzit quhen "sëmundje zoonotike". Nëse keni kafshe, sigurohuni që të kryeni kontrolle të rregullta dhe të verifikoni vaksinimin e tyre. Mbani fëmijët e vegjël larg nga fecet e kafshëve pasi mund të jenë burim për sëmundje si tërbimi ose gripi i shpendëve dhe pleshtat. Rekomandohet të jini të kujdesshëm kur hasni kafshë të egra.

Shikoni lajmet

Një verifikim i mirë i ngjarjeve të tanishme mund t'ju ndihmojë të merrni vendime të mençura rreth udhëtimit ose aktiviteteve të tjera rekreative. Për shembull, një shpërthim i gripit të shpendëve në Azi mund t'ju bëjë të mendoni dy herë për një udhëtim që keni planifikuar. Informohuni paraprakisht mbi shpërthimet e fundit të sëmundjeve epidemike para se të bëni një udhëtim.



Këshilla

Largoni toksinat nga organizmi me çajin e kulumbrisë

Kulumbria është një frut, lulet dhe frutat e së cilës gjejnë përdorim edhe në mjekësinë popullore. Këto fruta kanë vlera të shumta dhe i bëjnë mirë stomakut dhe gjakut e janë të pasura me antioksidantë gjithashtu. Kulumbria arrin të nxjerrë lëngjet me toksina nga trupi, djerstijten e rrjedhimisht largon papastërtitë dhe ul temperaturën.

Lulet, gjetet dhe lëkura e këtij fruti ndihmojnë në pastrimin e gjakut e më tej ka një funksion rregulator edhe në sistemin e tretjes pasi lufton konstipacionin, fryrjet, dhe diarene veçanërisht tek fëmijët. Për më tepër, çaji bimor përgatitet duke hedhur dy lugë me kulumbri të thatë në një filxhan me ujë. Në këtë formë, do të keni mundësi të stimuloni oreksin. Nëse konsumoni reçel kulumbrie ose marmalade, atëherë do të zgjidhni problemin e mostretjes ose të stomakut në përgjithësi. Lulet e bimës prunus spinosa mund të përdoren për të zgjidhur problemet e akumulimit të lëngjeve në trup, për të tretur gurët në veshka dhe problem të tjera të këtij organi. Ato ndihmojnë kundër dhimbjeve të stomakut dhe ato nervore. Gjithashtu, kjo bimë mjekësore ka aftësinë të luftojë inflamacionin e gojës dhe të fytit, e në rast se keni probleme të tilla mund të bëni gargarë me lëngun e frutit të freskët, ose me lëngun e gjetheve të kulumbrisë, të cilat shërojnë bajamet e acaruar. Kështu, vendosni katër gjethe të kulumbrisë në gjysëm litri ujë dhe ziejini për 10 minuta. Kullojeni lëngun dhe bëni gargarë 2 ose tre herë në ditë. Me kulumbri mund të bëni edhe shurup. Shtoni 450 gramë sheqer të bardhë dhe 2 lugë të mëdha me gonxhe



lulesh të kulumbrisë në 4.5 litra ujë. Ziejini së bashku. Kur shurupi të ftohet hidheni në shishe të sterilizuara. Mund ta holloni me ujë dhe ta përdorni për gargarë për të trajtuar bajamet dhe laringun e acaruar. Lulet e kulumbrisë mund të përdoren edhe për të trajtuar problemet me traktin respirator, sepse luftojnë simptomat e të ftohtit dhe kollës. Më tej, tulli i kulumbrisë së pjekur përdoret në industrinë e kozmetikës për pro-

dhimin e maskave të fytyrës dhe të bukurisë. Ju mund të përdorni edhe ekstraktin e kulumbrisë për të ruajtur elasticitetin e lëkurës, sepse ky frut është i pasur me vitaminë C dhe taninë. Vaji i kulumbrisë përdoret edhe kundër strijavave dhe njollave. Ndërkohë nëse pini ujë të përzjerë me ekstraktin pluhur të kulumbrisë kur jeni të acaruar, do të përjetoni një qetësim të menjëhershëm të nervave.



Konsumoni kungujt e njomë, më pak rrezik nga sulmet në zemër

Kungujt e njomë bëjnë pjesë në varietetin Cucurbita pepo, e kanë një sërë vlerash curative në organizmin e njeriut. Këto lloj kungujsh kanë pak kalori e për më tepër, kombinimi i fibrës dhe ujit (95%) që gjenden tek kungujt e njomë mbajnë nën kontroll oreksin tuaj, e ju ndihmojnë të digjni kalori dhe ju japin shumë energji. Gjithashtu, kungujt e njomë ju ndihmojnë me qeskat poshtë syve, pasi kanë të njëjtin funksion si trangujt për shkak të nivelit të lartë të beta karotenit dhe vitaminës A dhe C si edhe zinkut. Por sipas studimeve, falë përmbajtjes së lartë të



magnezit, kungujt e njomë ulin rrezikun e atakut në zemër dhe ishemiisë, pasi përmbajnë acid folik që është thelbësor në shkatërrimin e amino acideve të dëmshme që shkaktojnë atak në zemër dhe trombozë. Ndodh në shumë raste që kyçet dhe gjymtyrët e njeriut të preken nga inflamacioni i shkakton nga acidit urik në organizëm. Kungujt e njomë janë një burim i pasur me acide yndyrore Omega-3 dhe karotenoidë anti-inflamator që kundërshtojnë efektet e acidit të tepërt urik. Ndërkaq, ky perim mund të përdoret si një kurues shumë i mirë i astmës e luan një rol të rëndësishëm në forcimin e dhëmbëve dhe kockave. Vitamina C gjithashtu ndihmon në ruajtjen e sistemit imunitar dhe zgjidhjen e problemeve respiratore. Sakaq, kompleksi i vitaminave B dhe prania e zinkut dhe kaliumit ndihmojnë në shpërbërjen e sheqerit në trup.

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4900 përfituesit

ATP: Dosjet e vitit 1996, pronarët që kompensohen

Ish-pronarët, aplikimet e ezauruara

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4900 pronarë, të cilëve u është njohur e drejta për kompensim. Dosjet i përkasin vitit 1996. Lista me vlerësimin përfundimtar për subjekte është botuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Lista përmban të dhëna lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, mangësitë në dokumentacion apo vlerësimin përkatës jepen të detajuara në regjistrin që shqyeron këtë njoftim. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit si dhe vlerësimin financiar për çdo dosje.

KOMPENSIMI FINANCIAR

Bazuar në skemën që po ndjek qeveria në zbatim të ligjit të ri për pronat, prioritetet do të ketë prona truall, përkundër tokave bujqësore, që do të jepen për kompensim fizik. Pas shqyrtimit të

kërkesave, kompensimi financiar bëhet vetëm për ato subjekte, vendimi i të cilëve është përfundimtar, i ekzekutueshëm ose për kërkesat që nuk janë trajtuar asnjëherë për kompensim. Të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall, do të përfitojnë kompensim financiar nga fondit i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë. Ndërkohë, pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar do të kompensohet fizikisht nga fondit i tokës. Në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar për tokën truall rezultojnë se pjesa e mbetur është deri në 5 për qind më



e madhe se vlera 50 milionë lekë, atëherë subjekti kompensohet për të gjithë vlerën, në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar rezultojnë se pjesa e mbetur është më e madhe se 5 për qind mbi vlerën 50 milionë lekë, atëherë subjekti kompensohet me një pronë nga fondit

KOMPENSIMI FIZIK

Agjencia e Pronës ka në zotërim 23 mijë hektarë tokë bujqësore, për të cilat ka përfunduar më herët edhe vlerësimin ekonomik, të cilat do të përdoren për skemën e kompensimit fizik. Për ndarjen e kësaj sipërfaqjeje, dy do të jenë kriteret bazë. Kriteri i parë është rendi kronologjik i vendimeve, që do të thotë se, sikurse kompensimi financiar, edhe ky kompensim do të fillojë me vendimet më të vjetra në kohë. Kriteri i dytë lidhet me vendndodhjen e pronës që do të përfitojnë si kompensim fizik. Pra, pronari do të kompensohet me një pronë nga fondit

fizik, e cila gjeografikisht është më afër me pronën që i është njohur për kompensim. Në lidhje me dokumentet që duhet të depozitohen, ato nuk ndryshojnë, por mbeten të njëjta, si në rastin e kompensimit financiar. Ndryshon vetëm formulari i aplikimit, i cili është specifik për secilin rast. Në total janë 26 mijë vendime të formës së prerë, të cilat presin të kompensohen. Bazuar në ligjin e ri, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka nisur një proces të ri rivlerësimi, ku një metër katror tokë do të llogaritet me çmimet e tregut, por zëri kadastral nuk do të jetë ky i sotmi, por ai që ka pasur prona në çastin e shpronësimit.

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	----------------------------	-----------

(Vijon nga numri 1 djeshëm)

Tiranë	Besim Popa			
Tiranë	NESRET XHANI			1,912,125
Tiranë				
Tiranë	MYSLYM JUMA			1,716,415
Tiranë	SAFIE KAÇILA			
Tiranë	BESIM ZELIA			11,317,761
Tiranë	Naim Kollçaku			
Tiranë	Behije Dupi, Fate Dupi, Fiqiret Dupi, Lumturi Dupi, Nashije Dupi			
Korçë	Kostaq Necka			10,935
Korçë	Kostaq Necka			
Tiranë	XHEVDET LIBOHOVA			
Gjirokastrë	Bashkim Kadena			EZAURUAR
Korçë	Nevruz Kulla			
Korçë	Mishel Cico			361,180
Korçë	Mishel Cico			EZAURUAR
Korçë	Safete Velikollari			79,200
Korçë	Xhafer Shaqir Lenja			37,980
Korçë	Zyfi Bregu			303,760
Korçë	Mersin Lipo			210,000
Korçë				
Korçë	Mishel Cico			
Lezhë	Fran Ndue Frocku			468,090
Lezhë	Pjetër Mark Prenga			
Shkodër	Tonçe Bumci			-
Tiranë	ILIAZ MYFTIU			5,545,420
Tiranë	SOFIA POLOSKA			37,904,454
Korçë	Meksim Ceco			42,200
Korçë	Minella Blidof			220,712
Kukës	Perparim Çela			
Gjirokastrë	Veiz Karagozji			
Dibër	KADRI GJAPI			EZAURUAR
Korçë	Spirka Karamxa			EZAURUAR
Korçë	Aferdita Koçibelli			
Korçë	LUAN LAHOLLI			EZAURUAR
Korçë	Mergim Collaku			EZAURUAR
Kukës	Xhelil Kastrati			

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	----------------------------	-----------

Tiranë	JAHJA ENESI			2,854,200
Vlorë	Spiro Mustaqi			EZAURUAR
Elbasan	STEFAN SPIRO VESHO			4,900,180
Elbasan	FERIT QYTYKU			-
Korçë	GURADEM ZYFI			
Korçë	Enver Kollovozi			EZAURUAR
Korçë	Irakli Qirjako			2,966,995
Shkodër	Esat Qerpiku			3,129,088
Shkodër	Ded Plani			-
Shkodër	Ali Alushi			
Shkodër	Skeder Sykni			
Tiranë	SKENDER BASHA			EZAURUAR
Tiranë	NESTOR KOTE			68,341,865
Tiranë	Jakup Kokonozi			EZAURUAR
Durrës	Minella Leka			
Vlorë	Feto Xhemali			
Vlorë	Isa Braka			
Vlorë	Sherif Tava			
Vlorë	Numan Hodaj			
Vlorë	Qemal Myrtaj			
Vlorë	Petref Vranaj			
Durrës	Areti Leka			1,361,710
Korçë	Safet Myrtollari			849,037
Korçë	Haxhire Myrtollari			314,655
Korçë	Ali Panariti			2,987,584
Korçë	Luljeta Fecami (Hoxhalli)			1,145,067
Korçë	Valter Vincani, Vandush Vincani			1,533,572
Durrës	Ilir Basholli			
Durrës	Liljana Gurakuqi			EZAURUAR
Durrës	Lefteri Vasho			
Durrës	Fahri Bograzhda			
Durrës	Filip Leshnja			
Durrës	Xhelal Bajrami			
Elbasan	HANKO BALLO			1,330,855
Elbasan	SHABAN KULA			3,077,306
Elbasan	NEVRUS KOCI			
Elbasan	Isuf Elezi			

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	----------------------------	-----------

Elbasan	SKENDER KOTORRI			6,962,007
Elbasan	Gjyshate Bektashjane			
Elbasan	Emir Llaha			
Elbasan	TAJAR ÇEKREZI			7,435,688
Gjirokastrë	Lefter Nazo			
Gjirokastrë	Yilka Godeshi			207,004
Gjirokastrë	Sadik Male			42,900
Gjirokastrë	Kalica Ballabani			285,523
Gjirokastrë	Janul Lico			1,790,865
Gjirokastrë	Eduard Vaso			
Dibër	SHKURTE LACI			
Korçë	Miço Palloi			
Korçë	Abaz Bregu			281,760
Korçë	Ferdinand Prifti			1,422
Korçë	Kristofor Martiro			49,011
Korçë	Orhan Baçellari			
Korçë	Fadile Sula, Kasëm Sula			124,128
Korçë	Myslim Kasolli			32,448
Korçë	Sotiraj Gjoshë			47,808
Korçë	Safet Karafili			43,245
Korçë	Hajrulla Dilo			
Korçë	Koli Stefa			1,126,592
Korçë	Hysen Dervishi			
Korçë	Pellumb Ismaili			
Dibër	GJIN GJOK PALI			
Korçë	Gani Feka			
Dibër	ESAT KEPUKA			
Korçë	Nehim Hymettllari			
Korçë	Avdulla Pengu			EZAURUAR
Korçë	Behije Alinji, Valentina Alinji			193,656
Korçë				80,908
Korçë	Ismail Turka			83,462
Korçë	Sokol Tollaku			559,104
Korçë	Garip Molla			EZAURUAR
Korçë	Jetmir Muçllari			EZAURUAR

(Vijon nesër)

Shkencëtari rus: Prodhimi i agentit nervor u rafinua vetëm në Bashkimin Sovjetik dhe në Rusi

Sulmi ndaj Sergei Skripal, Rusia zbulon origjinën e substancës së përdorur në helm

Chizhov: "Novichok" ka dalë nga laboratorit britanik, s'kemi lidhje me sulmin

Rusia pretendon se agjenti kimik i përdorur për helmimin e ish-spiunit rus në Angli ka dalë nga një laborator britanik. Ambasadori rus në Bashkimin Europian, Vladimir Chizhov, në një intervistë për britaniken "BBC", përsëriti se Rusia nuk ka asnjë lidhje me sulmin ndaj Sergei Skripalit dhe vajzës së tij Yulia në Salisbury. Ambasadori sugjeroi se agjenti nervor, që sipas britanikëve i përket grupit "Novichok" të prodhuar në Rusi, mund të ketë dalë nga laboratorit "Porton Down", 12 km larg qytetit. "Porton Down është kompleksi ushtarak më i madh në Mbretërinë e Bashkuar, që merret me kërkimet mbi armët kimike", tha Chizhov. Sipas tij, Rusia nuk ka rezervë të agjentit kimik të pretenduar. Nërsa, Boris Johnson, sekretari i Jashtëm në Britaninë e Madhe, i cilësoi si qesharake pretendimet e Chizhovit. Sipas tij, kjo është një përpjekje tjetër e shtetit rus për të devijuar ngjarjen nga faktet se Moska ka shkelur në mënyrë flagrante detyrimet e saj ndërkombëtare. Johnson shtoi se Britania e Madhe ka prova se Rusia ka prodhuar dhe depozituar "Novichok" brenda 10 viteve të fundit. Sekretari për Punët e Jashtme bëri gjithashtu të ditur se përfaqësues të Organizatës për Parandalimin e Armëve Kimike (OPCW) mund të mbërrinin në Britani të hënën, për të testuar kampionë të agjentit nervor. Sakaq, gjatë ditës së shtunë Ministria e Jashtme e Rusisë, Maria Zakharova është shprehur se substanca e përdorur në helmimin e Sergei Skripal mund të ketë origjinën nga vendet që studiojnë agjenti nervor "Novichok". "Burimi më i mundshëm i origjinës së toksinës janë vendet që kanë kryer kërkime të thella për substancën nga programi "Novichok", përafërsisht që nga fundi i viteve 1990 deri tani dhe ky projekt nuk është vepër e Rusisë apo Bashkimit Sovjetik", - tha zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme, Maria Zakharova. Ajo listoi Mbretërinë e Bashkuar, Sllovakinë, Republikën Çeke dhe Suedinë midis vendeve të përfshira. "Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjithashtu duhet të vihen në dyshim", - u shpreh Zakharova në një intervistë për VGTRK. "Si dolën ata në përfundim për një gjurmë ruse nëse nuk na dhanë ato mostra? Logjikisht ata nuk duhet ta kenë këtë substancë. Cilat mostra kanë krahasuar me të për të nxjerrë një përfundim të

tillë?". - vazhdoi ajo. "Ngrihen pyetje: Atëherë, ata duhet të kenë mostra, të cilat ata i fshehin, ose është gënjeshtër që nga fillimi deri në fund. Nëse kryeministri i Britanisë së Madhe dhe ekspertët tjerë britanikë japin formulën, atëherë do të jetë e qartë se cilat vende kanë zhvilluar këto agjentë". Përfaqësuesi i Rusisë në organizatën për Ndalimin e Armëve Kimike (OPCW), Aleksandr Shulgin, kundërshtoi vërejtjet e ministres së jashtme të Rusisë, pasi sipas tij studimet për "Novichok" u hoqën nga Bashkimi Sovjetik pas rënies së tij. Ndërsa Shulgin nuk e ka treguar se ku është kontrabanduar programi, ai tha se burimi i substancës së përdorur në Salisbury është i fshehur në një nga vendet ku ky humllim ka vazhduar dhe ka arritur sukses të caktuar.



Foto ilustruese

Ministri i Jashtëm çek Martin Stropniq ka hedhur poshtë vlerësimin e Zakharovës për vendet ku agjenti i gazit nervor mund të kishte origjinën. "Ne e hedhim poshtë deklaratën e pabazuar mbi origjinën e

Novichok", - tha Stropniq, duke shtuar se akuzat ishin thjesht spekulative. Më parë, OPCW tha se asnjë nga shtetet e saj anëtare nuk ka deklaruar posedimin e grupit Novichok të agjentëve nervorë. Ndërko-

hë, shkencëtari rus, Vil Mirazaynov i cili fillimisht kishte ndihmuar në zhvillimin e agjentit nervor, që besohet se është përdorur për të helmuar ish-spiunin rus në Britani, thotë se edhe shtetet tjera mund të kenë

prodhuara mostra të substancës. Në një intervistë për "Current Time TV", Mirazaynov ka fajësuar Rusinë për helmimin, rast ky që ka ngritur tensionin në mes të Moskës dhe Londër, ku dy qeveritë kanë dëbuar diplomatët e shteteve të njëra-tjetres. Mirazaynov thotë se e ka publikuar formulën e agjentit nervor - të njohur si novichok - në një libër në gjuhën angleze të publikuar më 2008. "Britanikët kanë mundur ta kenë sintetizuar atë në bazë të formulave që unë kam publikuar në librin tim", thotë ai. "Shumë shtete mund të kenë mostra, por prodhimi u rafinua vetëm në Bashkimin Sovjetik dhe në Rusi", thotë Mirazaynov. Ndërkohë, ish-agjenti i shërbimeve sekrete Skripal dhe vajza e tij 33-vjeçare mbeten në gjendje kritike për jetën, në spital.


Mandati i katërt për Putin, lideri me qëndrimin më të gjatë në Kremlin

Rusi, Vladimir Putin fiton zgjedhjet presidenciale me 74% të votave

Miliona rusë kane votuar këtë të diel në zgjedhjet presidenciale, ku Vladimir Putini ka fituar përsëri. Putin kryesoi me 74% të votave, fitore më e madhe kjo sesa ajo e vitit 2012. Presidenti arriti të sigurojë mandatin e katërt në detyrë, duke e bërë atë liderin me qëndrimin më të gjatë në Kremlin, pas diktatorit Josef Stalin. Vladimir Putin rikandidoi për të gjashtë herë si president i vendit. Procesi zgjedhor u hap në orën 08:00 deri në 20:00 me orën lokale. Putin kandidonte përballë shtatë kandidatëve të tjerë. Mes rivalëve të tij përfshihet milioneri komunist, Pavel Grudinin, 57 vjeç, ish-drejtuesja e një "reality show", Ksenia Sobchak, si dhe nacionalisti veteran Vladimir Zhirinovskiy. Kundërshtari më i fortë i Putinit, agjenti kundër korrupsionit Aleksei Navalny iu hodh poshtë kandidatura, sepse ai ishte dënua për mashtrim në një rast të konsideruar gjerësisht si të motivuar politikisht. Navalny në përpjekje për të eliminuar rivalin ka bërë thirrje për

bojkotim të zgjedhjeve. Sakaq, gjatë votimit në procesin zgjedhor, u akuzua se ka pasur shkelje. Disa video të publikuara në mediat botërore kanë zbuluar disa raste të vjedhjeve të votave, në mënyrë që Presidenti rus Vladimir Putin të vazhdojë të

drejtojë vendin. Në tjetër zrytar vendos më shumë fletë votimi në një kuti dhe të gjithë këto janë filmuar nga kamerat e sigurisë. Gjatë votimeve autoritetet i drueshin pjesëmarrjes së ulët në zgjedhje e në disa rajone, rusët u inkurajuan të votojnë



Vladimir Putin

përmes ushqimeve falas dhe uljes së çmimeve nëpër dyqane. Zgjedhjet e këtij

viti janë të parat që u zhvilluan në Krime, që kur Rusia e aneksoi gadishullin nga Ukraina. Votimi përkoi me përvojtorin e katërt të traktatit të nënshkruar nga presidenti Putin, që e shpalli zyrtarisht Krimenë pjesë të Rusisë. Kjo lëvizje u kontestua ashpër nga Kiev dhe përkallëzoi tensionin mes Rusisë dhe Perëndimit. Si rezultat, rusët që jetojnë në Ukrainë nuk u lejuan të marrin pjesë në votim, me vendim të qeverisë së Kievit.

Ndryshimi i orës javën tjetër, Parlamenti Europian studim për efektet



Parlamenti Europian

Ediela e fundit e marsit do të sjellë edhe ndryshimin e orës për vendet e Europës. Pas debateve të shumta, Parlamenti Europian arriti në marrëveshje dhe votoi javën e shkuar për të mos hequr ende ndërrimin e orës. Eurodeputetët, me 384 vota pro dhe 153 kundër, kërkuan një studim shkencor përfundimtar mbi efektet që ndryshimi apo mos ndryshimi i saj do të sillte përpara se të merret masa e heqjes së ndryshimit. Ndërrimi i orës sipas asaj diellore-parashikon kursim të madh të konsumit të energjisë elektrike. Ky ndryshim u vendos me ligj në Europë në shekullin e kaluar. Kjo erdhi si një mënyrë për të përfutur nga drita

diellore dhe për të zvogëluar në maksimum konsumin e energjisë elektrike për të ndriçuar. Rregulli i ndryshimit të orës është vendosur që në shekullin e tetëmbëdhjetë, ku i pari ka qenë Benjamin Franklin, i cili hodhi teorinë se me realizimin e tij do të kursejesh shumë energji.

Por, hulumtimet kanë treguar se ndryshimi i kohës ndërpret orarët e gjumit dhe mund të ndikojë në produktivitetin në punë. Studime të shumta kanë dështuar të arrijnë në një konkluzion të përbashkët, megjithatë kanë treguar se ka efekte negative tek shëndeti i njeriut. Ndërrimi i orës është bërë i zakonshëm gjatë viteve '70, por është testuar edhe më herët, si nga Britania e Madhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Shqipëria dhe Spanja ishin të parat në Europë që filluan të zbatonin orët e verës dhe orët e dimrit në vitin 1974. Në Shqipëri, deri pak vite më parë, ndryshimi i orës dy herë në vit

shpallej vetëm me vendim dhe njoftim të posaçëm qeverie, por vitet e fundit kjo nuk është aplikuar më nga qeveria shqiptare dhe njoftimim për qytetarët e bëjnë vetëm mediat, duke iu referuar rutinës së përvitshme të ndryshimit të orës. Politikantët e lartë në Lituanë, Poloni dhe Suedi gjithashtu kanë kritikuar ndryshimin e kohës, i cili përdoret në pjesën më të madhe të Amerikës së Veriut. Kritikët e sistemit thonë se kjo mund të shkaktojë probleme afatgjata shëndetësore, veçanërisht në mesin e fëmijëve të vegjël dhe të moshuarve.

Opinion i Ditës

Nga Fatos Çoçoli

Rrëshqitja e palumturisë

(Vijon nga faqja e parë)

... si një mënyrë dhe shtysë për të nxitur barazinë mes shtresave shoqërore dhe një vëmendje të shtuar ndaj vendeve dhe shtresave në nevojë. Po si vijmë ne shqiptarët në këtë ditë? Nga anketat e zhvilluar po nga OKB, duke angazhuar ndër strukturat më të njohura dhe të besueshme sot në botë përsa u përket pyetësorëve (sondazheve), institutin "Gallup", dalim në vendin e 112-të nga 156 shtete të intervistuar. Praktikisht të fundit në Evropë. "Gallup" ka intervistuar nga 1 mijë qytetarë në çdo shtet. Treguesit ku ba-

het të ishim mirë. Po ashtu, tek të ardhurat për frymë renditemi më mirë se Bosnje-Hercegovina, Moldavia, Kosova, etj.. Ndërkohë, në tërësi në këto intervista të "Gallup" shfaqemi më pak të lumtur se shtetasit e këtyre shteteve dhe të të gjitha shteteve evropiane. Po pse? Cilat janë shkaqet që ndryshe nga vitet 2008-2010, në periudhën 2015-2017 jemi përkeqësuar, kemi zbritur në renditje me 17 vende (në vitin 2016 renditeshim në vendin e 95-të në botë). Në atë që në gjuhën teknike të ekspertëve të "Gallup" cilësohet si "rrëshqitja e palumturisë", jemi ndër 10 vendet në botë që kemi përkeqë-

vret çdo shpresë për një të ardhme më të mirë të vendit. Mjafton të shikojmë arrestimet e fundit për masakrën në Lezhë në tokat e bregdetit shqiptar dhe abuzimet e përbindshme me 610 kilometrat bregdet që kemi. Lezha është vetëm maja e ajsgbergut. Dhe ndodh një dukuri, që nuk e vëren as edhe në vende të ngjashme për nga fuqia dhe zhvillimi ekonomik me ne, si Maqedonia dhe Mali i Zi. Tek ne nuk ankohen vetëm qytetarët, por edhe sipërmarrësit, ata që normalisht duhet të jenë më të lumturit, pse kanë para me qindra, në mos mijëra herë më shumë se shtetasit e zakonshëm

drejtuesve të hipotekave, apo të spitaleve publike, edhe pse fillimisht ngjallën shpresë, nuk e kanë zgjuar gjigantim, kthimin e përgjegjshmërisë në administratën tonë publike, frikën ndaj ndëshkimit nga ligji. Kanë qenë më shumë një shkrim i mërzisë kryeministrotre, ndaj një administrate publike që vijon të jetë kokëfortë dhe mospërfillëse në abuzimet e saj. Formula dhe qasja e qeverisjes me qytetarët, si dhe platforma e bashkëqeverisjes me dhe për qytetarin, rrezikojnë të ngelen butafori me disa raste-spektakël zgjidhesh llojesh të qytetarëve me administratën, ndërkohë që mijëra raste



zohet pyetësori i "Gallup" janë gjasthtë: të ardhurat për frymë, pritshmëritë për një jetë të shëndetshme, mbështetja nga miqtë dhe të afërmit, të dhënat për bamirësi, liria për të bërë zgjedhje në jetë dhe niveli i perceptuar (që ndjen çdo qytetar) i korrupsionit. Duke i parë këto kritere, të ngjan paradoksale, pse ne, si traditë, kemi një familje shumë të konsoliduar dhe që bën për anëtarët e saj. Pra, tek kriteri "mbështetja nga të afërmit" duhet realisht të shkëlqejmë. Po ashtu, lindim dhe rrisim fëmijë të mrekullueshëm, pra te treguesi "pritsshmëritë për një jetë të shëndetshme", sërish du-

simin më të madh (të nëntët në botë). Dhe lind e natyrshme pyetja: pse duhet të zbrisim në renditje kaq fort, gati si vende në luftë civile, si Siria? Cfarë i bën qytetarët tanë kaq të palumtur? Pse ndjehen kaq të stresuar, të pashpresë ata? Ndoshta përgjigjen e jep vetë njëri nga nën-treguesit kryesorë të anketës së "Gallup", ai për konsideratën e qytetarëve ndaj korrupsionit. Nëntë ndër dhjetë qytetarë, shqiptarë të Shqipërisë mendojnë se korrupsioni tek ne është në rritje. Se ai nuk është frenuar. Korrupsioni dhe abuzimi i pandëshkuar me pronën dhe shërbimin publik

dhe kanë siguruar edhe të ardhmen financiare të nipërve. Ankohe mi të gjithë, pa dallim, për shërbimet e munguara apo të një cilësie shumë të keqe, të administratës sonë publike. Në këtë situatë stresi të gjithëgjendur në çdo pore (ind) të shërbimit publik, sigurisht që ndjesia e të qenit i plotësuar apo i lumtur është inekzistente, zero. Prandaj dhe vendi ynë i ka qytetarët e tij më të palumturit e Evropës dhe po ashtu, edhe më të pashpresët. Në duart e kësaj qeverie të sotme është shansi, sfida e jashtëzakonshme e kthimit të shpresës. Deri tani lëvizjet-spektakël, si dorëheqja e imponuar e të gjithë

të tjera presin me ditë, javë dhe muaj një zgjidhje që nuk vjen. Koordinatorët e bashkëqeverisjes, nëse kërkojmë të jenë efektivë, duhet të dhjetëfishohen. Ambasada e SHBA-ve në Shqipëri është efektive, pse ka një personel sa një ministri e shtetit tonë dhe mirë bën, pse po na shërben edhe ne (krahas vendit të vet) me gjetjet dhe informacionin që mbledh. Nëse bashkëqeverisja nuk shndërrohet në një shtet brenda shtetit, që kontrollon dhe jep rrugëdalje për interer të çdo qytetari që i ankohet (aty ku ankesa është e bazuar), ajo rrezikon të jetë thjesht një shashkë, butafori më shumë.

HOROSKOPI

DASHI

Parashikohen ndryshime. Për momentin, mos merrni vendime të prera, që mund të mos jenë më të duhurat. Prisi na që qartësohen gjërat. Mos bini pre e tundimit për të reaguar menjëherë, sidomos në punë. Rrezikoheni nga shpërqendrimet.

DEMI

Këtë ditë do të ndiheni të sigurt nga një ndjenjë praktike dhe nga largpamësia në investime dhe në projekte. Kemi dëshirë të jetoni në thellësi të shpirtit tuaj, atë që deri më tani e keni jetuar në nivel të mendjes. Mos humbni kohë për këtë!

BINJAKET

Mos u gënjeni nga shkëlqimi i një momenti pasioni që bën që t'ju rrahë fort zemra, sepse mund të dalë se është krejt ndryshe nga sa duket. Bashkëqeverimi i planetëve në shenjen e juaj bën që të keni pak dëshirë të angazhoheni. Përpiquni të jeni më i gatshëm.

GAFORJA

Do të keni prire për t'u mbyllur brenda vetes për të rëmur në të kaluarën. Por do të merrni në konsideratë edhe mundësinë e së tashmes. Kontakti me persona të veçantë do t'ju hapë horizonte të reja dhe do t'ju japë mundësinë të përmirësoheni.

LUANI

Nëse është krijuar pak tension me partnerin, mos e lini çështjen pa e sqaruar me hollësi. Për të kthyer harmoninë do të jetë më e thjeshtë sesa mendoni. Përfitoni nga mbështetja që ju garanton familja, për të përmbytur zgjedhjet që do të bëni.

VIRGJERESHA

Kjo e hënë do të jetë disa e vështirë, me shumë keqkuptime, ankesa dhe mendime jo shumë optimiste. Sot në dashuri do të jeni pak jashtë ritmi. Megjithatë, nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, por ndërkohë dëshira për t'u larguar nuk e favorizon mirëkuptimin.

PESHORJA

Përpiquni të jeni më të dashur, pasi ju bën vegjë mirë. Padyshim, do të lehtësonte njëshëm raportet me personin që keni në krah. Ndërrhyja e një familjari në punët tuaja do t'ju nevojzojë disi, por nuk keni çfarë bëni.

AKREPI

Do të përballeni me një zgjedhje të rëndësishme, qëndroju zgjedhjeve të bëra më parë dhe mos hiqni dorë nga autonomia e juaj. Mos i lejoni një familjari t'ju pengojë. Do t'ia dilni të angazhoni në nisimat që keni ndërmarrë, duke prekur pikat e duhura emocionale.

SHIGJETARI

Në një ditë si kjo e sotmja, nuk duhet ta çoni nëpër mend të ndryshoni botën. Si zakonisht, mbi të gjitha për çështje pune, reagoni duke u mbështetur mbi vendosmërinë dhe saktësinë.

BRICJAPI

Në familje do të keni disa kundërshtime të shkakutara nga këndvështrime të ndryshme. Mos u mërzisni, larmishmëria është gjithmonë diçka pozitive, që duhet shfrytëzuar për t'u ngritur. Falënderoni miqtë që ju rrin prapë duke ju dhënë ide dhe mundësi të mira.

UJORI

Shmangni marrjen e angazhimeve për të cilat jeni të sigurt se nuk do të mund t'i çoni deri në fund. Duhet të mësoni të thoni 'jo', kur është e nevojshme. Për shkak të Plutonit që ju kundërshton, parashikohen disa vonime në udhëtime si edhe keqkuptime në punë.

PESHQI

Jeni të detyruar të merrni me çështje praktike të mërzitshme dhe kjo do t'ju prishë humorin. Nëse një nga propozimet tuaja bie nësh me ndonjë pengesë, mos u dekurajoni. Mos u zmbërapsni nga rrethana pak të përshtatshme dhe thoni gjithmonë atë që mendoni.

Opinion i Ditës

LIBRI RI I SHABAN MURATTI

Enigmat dhe përgjigjet për çështjen e detit

(Vijon nga faqja e parë)

... diplomatike greke apo shqiptare?", botuar nga Fondacioni Kulturor "Alsar", Tiranë. Fryt i një pune studimore të gjatë disave vite, libri trajton një nga çështjet më interesante dhe më intriguese të diplomacisë shqiptare në të gjithë historinë e shtetit shqiptar, e cila ka marrë emrin çështja e detit. Është një çështje diplomatike, e cila lindi nga marrëveshja midis qeverive të Shqipërisë dhe të Greqisë në vitin 2009, e anuluar nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë në vitin 2010 dhe e cila mori statusin e një prej konflikteve kryesore diplomatike midis dy vendeve gjatë gjithë dhjetëvjeçarit që pasoi deri në ditët tona.

Libri del në një kohë kur çështja e detit ndodhet në apogjeun e debatit, të polemikave, të pikëpyetjeve, të dyshimeve dhe të enigmave. Ndonëse një çështje e nxehtë dhjetëvjeçare në marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve, çështja e detit karakterizohet nga një shkallë e madhe e mungesës së njohurive, mungesës së interpretimeve diplomatiko-juridike, mungesës së profesionalizimit dhe të studimeve shkencore, dhe të shumë paqartësisë në qarqet politike, diplomatike, shkencore dhe publike të Shqipërisë.

Libri i Shaban Muratit për çështjen e detit vjen në kohën e duhur të interesit publik, shkencor dhe diplomatik, duke analizuar enigmat, por edhe duke dhënë përgjigjet për çështjen e detit. Duke u bazuar në një dokumentacion të ri arkivor, të panjohur, të patrajtuar dhe të anashkalluar, duke ndjekur dinamikën e gjenezës së çështjes së detit, të lindjes dhe të komplikimit të saj, duke ndjekur me skrupulozitet shkencor përplasjen diplomatike midis dy shteteve në format dhe në efektet përkatëse, autori jep për herë të parë një analizë diplomatike të plotë të çështjes së detit në gjithë harkun kohor të zhvillimit të saj deri në ditët tona.

Duke u mbështetur në vendimin historik të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, autori sjell një shtjellim interesant profesional, diplomatik dhe historik, të vendimit dhe të qëndrimeve juridiko-shkencore të Gjykatës Kushtetuese, të interpretuara nga këndvështrimi i mendimit diplomatik shqiptar dhe duke evidentuar piketat e mëdha strategjike të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, të cilat për arsye të panjohura janë lënë në errësirë nga institucione, nga memorandume dhe nga rekomandime shtetërore gjatë 10 viteve.

Analiza e çështjes së detit nuk mund të mos përfshinte kompleksitetin e gabimeve dhe të keqinterpretimeve, që karakterizuan negociimin e marrëveshjes së anuluar, për të mos u përsëritur ato gabime në kohën e sotme nga diplo-



macia dhe shteti shqiptar. Ai ndalet në zbërthimin e enigmës së ecjes së diplomacisë shqiptare me shpejtësi raketë për të përfunduar në vitin 2009 marrëveshjen e detit, një tematikë delikate dhe tepër e komplikuar, e cila si rregull në praktikën ndërkombëtare kërkon dekada të tëra bisedimesh për t'u zgjidhur. Duke e analizuar çështjen me syrin e një diplomati me përvojë të madhe analitike, autori trajton disa drejtime, të cilat janë anashkalluar në ecurinë e negociimit të marrëveshjes dhe të vetë çështjes së detit. E tillë është enigma e transformimit të objektit të bisedimeve për detin midis dy Ministrive të Jashtme në vitet 2008-2009, të cilat në mënyrë të paligjshme ndërruan objektin e tyre. Kërkesa fillestare e MPJ të Greqisë drejtuar MPJ të Shqipërisë në vitin 2007 ka qenë për hapjen e bisedimeve për shelfin kontinental. MPJ e Shqipërisë në mënyrë të paligjshme e ka ndryshuar këtë objekt në bisedime për delimitimin e kufijve detarë, gjë që sipas Gjykatës Kushtetuese, është e gabuar. Gjykata e Kushtetuese e ka shpallur marrëveshjen e detit të vitit 2009 të papërfundshme me Kushtetutën e Shqipërisë, jo vetëm për mungesën e plotfuqishmërisë, por ajo që është më e rëndësishme, ka shpallur si të paligjshëm bisedimet për kufijtë detarë midis dy shteteve. Kjo pjesë e vendimit duhet të jetë vijë e kuqe për çdo tentativë të ndonjë institucioni për të zhvilluar bisedime me temën e detit midis dy shteteve.

Libri trajton në mënyrë shkencore një nga teoritë dhe qëndrimet më të gabuara të bisedimeve për marrëveshjen e detit të vitit 2009 dhe të disa institucioneve kryesore të Shqipërisë se goja kufijtë detarë

midis dy vendeve nuk kanë ekzistuar. Është një teori, që dëgjohej ende prapa kuintave të disa institucioneve shtetërore. Me një dokumentacion të pasur arkivor nga arkivi i MPJ të Shqipërisë dhe arkivi të tjera, libri sjell referenca dokumentare të pamohueshme nga historia e marrëveshjeve me Greqinë për ekzistencën dhe pranimin zyrtar të kufijve detarë nga qeveritë e të dyja vendeve. Ky aspekt i çështjes së detit është tepër i rëndësishëm, sepse gjatë dekadës që ka kaluar nga nënshkrimi i marrëveshjes së anuluar, ka institucione dhe zyrtarë, të cilët nën efektin e ndikimeve të errëta përipiç të rimodelojnë marrëveshjen e anuluar me justifikimin e teorisë së mungesës së kufijve detarë. Autori sjell një galeri aktesh dhe traktatësh ndërkombëtarë, që kanë përkatuar kufijtë detarë e tokësore dhe të cilat janë nënshkruar edhe nga qeveria e Shqipërisë, edhe nga qeveria e Greqisë në vitet 1925-1926. Në këtë kuadër autori analizon për herë të parë sindromën negative historike dhe vetëvrasëse të diplomacisë shqiptare, e cila mënjanon vetë karakterin detyruës ndërkombëtar të kufijve të Shqipërisë me Greqinë dhe e redukton atë në një problem dypalësh, duke u hequr akteve ndërkombëtare efektin e tyre ligjor dhe historik.

Ka rëndësi të theksohet se çështja e detit nuk është histori dhe meritë e autorit dhe e librit është se nuk kufizohen në aspektin historik, por enigmat historike të çështjes së detit i studion dhe i ndriçon në funksion të ndihmës së qëndrimit dhe të veprimit të diplomacisë dhe shtetit shqiptar sot. Ndaj merr vlera të mëdha aktuale fakti që autori i kushton pjesën më të

madhe të librit aktualitetit të çështjes së detit si një çështje e hapur diplomatike midis dy shteteve. Për këtë qëllim, ai sjell në skanin profesional të pasur arkivor nga praktikave dhe intrigave diplomatike të përdorura nga diplomacia greke gjatë dhjetë viteve për të imponuar në një formë apo tjetër efektet e marrëveshjes së anuluar të detit. Kjo kronikë përfshin lëvizje të tilla të diplomatike, si përpjekja për ta zbatuar në terren në mënyrë të njohshme marrëveshjen e anuluar, përpjekja për të imponuar rinëgocimin e marrëveshjes së anuluar me një gjysmë redaktimi të titullit, oferta dinake për të ridishtuar disa koordinata të marrëveshjes së anuluar dhe për t'i kthyer Shqipërisë një pjesë të asaj, që do të humbte me marrëveshjen e anuluar, përpjekja për ta maskuar ringjalljen e marrëveshjes së vjetër me ambalazhin e "paketës globale të zgjidhjes së problemeve shqiptaro-greke", këshilla e gabuar për ta dërguar çështjen e marrëveshjes së anuluar të detit në gjykatën ndërkombëtare apo arbitrazh ndërkombëtar etj., e deri tek alarmi që ngre në libër i pari autori për përvijimin e kërcënimit të revizionimit edhe të kufijve tokësorë të Shqipërisë me Greqinë.

Çështja e detit nuk mund të kuptohet pa njohur me themel tërë kuadrin e problematikës dhe të marrëdhënieve aktuale midis dy vendeve. Duke qenë një nga ekspertët më të mirë të Shqipërisë për marrëdhëniet shqiptaro-greke dhe për Ballkanin, autori analizon në librin e tij për herë të parë një botim shkencor problematikën dhe tërësinë e çështjeve të hapura dhe të pazgjidhura, që ekzistojnë midis dy shteteve dhe të cilat për

shumë dekada kanë mbetur jashtë rendit të ditës të tratativave dy-palëshe. Në libër gjejmë trajtesën e duhur çështja e ligjit të luftës, çështja e varrezave greke dhe mosrealizimi i reciprocitetit për varrezat të partizanëve shqiptarë në Çamëri, çështja e mprehtë historike dhe aktuale çame dhe ndërkombëtarizimi i saj, çështja e ujërave të ëmbla dhe sidomos e lumit Vjosa, ku Greqia në mënyrë të njohshme ka rrembyer kuotat ujore shqiptare pa përfillur konventat ndërkombëtare, çështja e reparacioneve të Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore që Shqipëria duhet t'i kërkojë Greqisë, çështja e ortodoksizmit politik të diplomacisë greke dhe pretendimet e saj për proteksionin e ortodoksëve shqiptarë, etj.

Vegori e nivelit të lartë profesional diplomatik dhe shkencor të librit është se autori ka parashtruar përgjigjet e të gjitha enigmave të çështjes së detit. Libri "Çështja e paqenë e detit: Një intrigë diplomatike greke apo shqiptare?" ndriçon enigmat e kaluara dhe të sotme, që përmban dosja e nxehtë e asaj, që quhet çështja e detit. Në këtë linjë libri sjell një kontribut të madh teorik dhe praktik për zhvillimin mbi baza të drejta të marrëdhënieve midis dy shteteve, për zgjidhjen e problemeve të hapura dhe në mënyrë të veçantë për çështjen e detit. Nëpërmjet një analize të thellë dhe shteruese shkencore, autori i përmbahet përfundimtar se çështja e detit nuk është dhe nuk mund të jetë kurrë çështje e diskutimit të kufijve shtetërorë detarë, të cilat janë përcaktuar njëherë e mirë nga aktet, marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare. Çështjet e vetme detare, që mund të bëhen objekt i bisedimeve sipas tij janë ato, që kanë të bëjnë me shelfin kontinental dhe me zonën ekonomike ekskluzive, tema që nuk kanë qenë objekt i ligjit ndërkombëtar në kohën e konferencave të Londrës, Firencës dhe Parisit në vitet 1913-1926, që përcaktuan kufijtë përfundimtarë të Shqipërisë me Greqinë dhe me Jugosllavinë.

Libri i ambasadorit Shaban Muratit është një udhërrëfyes serioz, diplomatik dhe shkencor në përputhje me interesat shtetërore e kombëtare dhe sjell një ndihmesë të madhe për diplomacinë, politikën, shtetin dhe shkencën shqiptare dhe sidomos për mendimin diplomatik e politik shqiptar. Libri "Çështja e paqenë e detit: Një intrigë diplomatike greke apo shqiptare?" shërben si gur prove për të matur dhe kuptuar realisht çdo cikël tratativash apo marrëveshjes, që mund të prodhohen midis dy vendeve rreth temës detare. Për shkak të interesit të madh të temës në qarqet diplomatike dhe akademike, shqiptare, rajonale dhe më gjerë, libri është botuar njëkohësisht në gjuhën shqipe dhe angleze.

Penallti inekzistente për të zotët e shtëpisë, një e paakorduar për miqtë

Skënderbeu merr tri pikët, Sino "tërbon" Luftëtarin

Gjyqtari fierak e bën baltë me gabime



Jeton Selimi

Skënderbeu fluturon me plot kuptimin e fjalës drejt titullit të shtatë në histori, ndërsa për të realizuar më mirë fitoren ndaj Luftëtarit është dashur dhe fluturimi i Ali Soues në zonë, i cili fiton një penallti inekzistente, që kontestohet fort nga miqtë, të cilët akuzojnë arbitrin Sino për gjykimin të njëanshëm. Ndonëse gjyrosktritë vijnë me mungesa, ata arriten t'u hapin jo pak telashe vendësve, të cilët gjithsesi krijuan iluzionin se i mbyllën hesapet që në pjesën e parë. Në minutën e 23-të është Lilaj, i cili gjuan drejt portës, duke vënë në veshitirësi Athanasopoulos, i cili devijon duke shpëtuar katërkëndorin. Në minutën e 31-të Gavazaj merr topin dhe zhvendoset nga e djathta drejt qendrës, duke tentuar portën me një gjuajtje të fortë, portieri i Luftëtarit pret në pozicion. Dy minuta më pas vendësit kalojnë në epërsi. Xhejms Nigeriani shpërthen në krahun e majtë dhe pasi hyn në zonë, mposht portierin kundërshtar me një goditje të zgjuar. Në minutën e 36-të është Luftëtari që ngacmon, por Shehi kontrollon në dy kohë gjuajtjen me kokë të Aleksit. Abazaj shpërthen në të 41-ën nga



mesfusha dhe gjuan fort, por jashtë kuadrantit. Momenti i parë i diskutueshëm në këtë ndeshje do të vijë në minutën e 44-ët. Soue lëshohet në zonë dhe e shtyn topin përpara ndërhyrjes së portierit Athanasopoulos, që shmang kontaktin me sulmuesin, por për kryesorin Sino çuditërisht ka penallti. Nga pika e bardhë paraqitet Sabien Lilaj, që ekzekuton

saktë, duke e çuar Skënderbeun në avantazh të dy golave në pushim. Por edhe pjesa e dytë do të nisë me pretendime për 11-metërs, kësaj radhe janë gjyrosktritë që e cilësojnë faull prekjen me dorë të topit në zonë nga ana e Micit, që i heq mundësinë e kontrollit kundërshtarit dhe protestojnë tek anëtori Tararaj, që lë lojën të vazhdojë. Soue

shfaqet rrezikshëm në minutën e 56-të, por gjuajtja e tij do të përfundojë jashtë kuadrantit. Në minutën e 64-ët Shehi i dëmtuar i lë vendin Teqes, që bëhet menjëherë protagonist në minutën e 71-të, me daljen e pastudiuar që i lejon Liçajit të shkurtojë diferencën. Por në minutën e 85-të Teqja bën mrekullinë në skemën e bukur të

KATEGORIA SUPERIORE	
JAVA E 26	
TË DIELËN	
Laci - Kamza	2-0
Lushnja - Teuta	2-3
Skënderbeu - Luftëtari	2-1
TË HËNËN	
Kukësi - Villaznia	
Partizani - Flamurtari	
RENDITJA	
Skuadra	P
Skënderbeu	60
Kukësi	42
Laci	42
Luftëtari	37
Flamurtari	37
Partizani	36
Kamza	34
Villaznia	27
Teuta	26
Lushnja	10

jugorëve, që nxjerrin Lamçen para portës, por do të presë gardiani i korçarëve. Në minutën e 93-të Xhejms kërkon të mbyllë ndeshjen me një ekzekutim plot hijeshi, por topi do të dalë ngjitur me shtyllën. Mbyllet 2-1 në Korçë, me Skënderbeun që ngjitet në kuotën e 60 pikëve, ndërsa Luftëtari mbetet i katërti me 37 pikë.

TRAJNERI I SKËNDERBEUT



Daja: Penalltitë? Epo jetojmë në Shqipëri!

Trajneri i Skënderbeut, Ilir Daja, refuzon idenë që gjyqtarët të kenë vepruar në ndihmë të ekipit të tij. Në "Gol pas Golit", ai ka bërë të qartë se nuk do të merrej me rastet e ndeshjes ndërsa i ktheu përgjigje edhe homologut të tij, Hasan Lika i cili kishte kërkuar që Soue të kishte refuzuar vendimin e gjyqtarit për penallti. "Nuk është nevoja ta ndjek, Skënderbeu nuk ka nevojë për 11-metërs, jemi ekipi që bëjmë diferencë të dukshme nga të tjerët. Ashtu e ka parë arbitri dhe nuk kam nevojë të diskutoj se kur nuk na jepet, nuk e kam diskutuar. Nëse kjo është gjykuar si penallti apo jo, nuk merrem me këtë, nuk ka pse gjykohet Skënderbeu, po shihni se edhe në pjesën e dytë nuk u dha një për ne. Miku im Lika ka ngatërruar vendin ku jetojmë ne, sepse fair play këtu është paksa i ekzagjuar. Megjithatë, pa i hyrë elementëve të penalltisë, kështu i ka gjykuar ai".

TRAJNERI I LUFTËTARIT

Lika: Soue duhej t'i kishte treguar arbitrit. Penalltinë tonë nuk donte ta jepte



Skënderbeu ka arritur të fitojë takimin ndaj Luftëtarit me rezultatin 2-1, në javën e 26-të të Superiores. Megjithatë, ky takim ka qenë i kontestuar, për shkak të gabimeve të arbitrit të bërë gjatë këtij takimi. Në një intervistë për "Supersport", Lika është shprehur se penalltia e fituar nga Soue duhej anuluar nga vetë arbitri, ndërsa ka komentuar penalltinë e paakorduar për Luftëtarin. "Pavarësisht rezultatit të pjesës së parë që nuk ishte i merituar, ne vazhduam të luftonim dhe duhet të kishim dalë me të paktën një pikë nga fusha e lojës. Pamjet të penalltia flasin vetë. Këtu është nga ato rastet që futbollisti duhej t'i thotë arbitrit që nuk është penallti. Nëse do të ishte një futbollist i imi, nuk do të preferoja një penallti të vjedhur në mënyrë të tillë, pasi ne nuk dimë të vjedhim. Nuk ka pasur pamje anësori ndoshta të penalltia që duhet të jepte në favorin tonë".

KAMZA DORËZOHET

Uzuni dhe Rexhinaldo ngjisin Laçin në vendin e dytë



Laci thyen Kamzën në një pjesë të dytë të shkëlqyer dhe kërcënon vendin e dytë të Kukësit. Ngjijtja e kurbinasve në këtë fazë të tretë është vërtet e ndjeshme, teksa e shohin vendin në vendin e dytë në tabelë me 42 pikë, po aq sa Kukësi, por kampionët e Shqipërisë luajnë nesër ndaj Villaznisë takimin e tyre. Në Kurbin Kamza mbetet me 10 vetë shumë shpejt, kur në minutën e 18-të Erlis Frashëri largohet nga fusha me karton të kuq për protesta. Më pas në pjesën e dytë, Myrto Uzuni në minutën e 70-të dhe Rexhinaldo në kohën shtesë, duke vultur fitoren e tretë radhazi të bardhezinjve, ndërsa Kamza e çon serinë pa fitore në 5 ndeshje.


GOLA PA FUND

Lushnja fiton një pjesë, Teuta merr tri pikët



Në "Roza Haxhiu" Lushnja tenton befasinë ndaj Teutës, madje duket se e prek me një dorë, kur në minutën e 34-ët e sheh veten në avantazh të dy golave, pasi Mikel Canka kishte realizuar më parë dhe në minutën e 14-të. Megjithatë, pa u mbyllur pjesa e parë një gol i Hilës mban gjallë shpresat e Teutës, që në pjesën e dytë fillimisht do të barazojë me anë të Gjeorgjevskit, ndërsa në kohën shtesë është Dediç që realizon një gol të shkëlqyer nga goditja e dënimit, duke bërë që bregdetarët të kthehen në shtëpi me pikë të plota. Lushnja mbetet e fundit në tabelë, ndërsa Teuta kërcënon vendin e tetë të Villaznisë, pasi ngjitet në kuotën e 26 pikëve nga 27 që kanë shkrodranët.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë e pasur me minerale.
7. Ascoli në tabela.
11. Një mund të jetë diplomatik.
12. Premtojë të bëhen kampionë të tillë.
14. Janë felinë të egër.
16. Marubi i fotografisë.
18. Janë meduza.
19. Një anarkist i famshëm.
21. Smith filozof.
22. Susanna shkrimtare italiane.
23. Shkurt për company.
24. Organizma Autonome Kombëtare.
27. Mbarojnë punime.
28. Ndezur në aparaturë.
29. Bëjnë arte me re.
30. Nduket për gjysmë.
31. Mbyllin fushatat
32. Luca bomber.
34. Emri i parë i Pasolin-i.

VERTIKAL

1. Numër i shkurtër.
2. Britame Arkimediti.
3. Inicialet e Paganini-t.
4. Fundi i Turandot.
5. Eshhtë fjetore ushtarësh
6. Parker regjisor.
7. Kështu quhet që ushqim kundër intoksikimit.
8. Një birrë e jona.
9. Mund të jenë përirimi.
10. Festat pa fat
11. Qendër ditore
13. Janë nomadë.
15. Fillojnë atletikën.
16. Eshhtë brinjë në skuadër.
17. Sidney i Serpico.
18. Qe centauri që mësonte Akilin.
20. Në mes të një kanali.
25. Bëhet për zakon.
26. Tregon martesë.
27. Një super... për shopping.
33. Vala e stadiumit.
34. Fillojnë poshtë.
36. Një provë... inteligjence.
38. Vaçe e famshme e këngës tonë.
41. Fillojnë vallen.
42. Para es Salaam.
43. Linearë pa larë.
46. Nota e diapazonit.
47. Mbyllin një shtëpi.
49. I keni në dorë.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Eshhtë skuadra e donatorëve
7. Mbyllin një turp.
9. Mund të jetë unik
11. Një i absurdit është i Samuel Beckett
14. Qyteti i përjetshëm.
15. Interpretin Sandokan.
17. I ka tek tenda.
18. Eshhtë këngëtar lirik
19. Arturo i Brecht.
20. John, i forti i Sylvester Stallone-s.
21. Françesku kantautor.
22. Eshhtë religjion politeist.
25. Qerre pa qe.
26. Gjysmë alarmi.
27. Eshhtë shtypi i ZP.

VERTIKAL

1. Janë çnjerëzore.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Edi në krye të PS.
4. Eshhtë lloj papagalli.
5. Fund turni.
6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
7. Para devils për lojtarët e Manchester United.
8. U shkrua nga Kadare
10. Conan ai i Schwarzenegger.
11. Pak itanike.
12. Arbeni pa çifte.
13. I ka tek treni.
15. Mund të jenë pushimi
16. Mund të prishej nga një... kleçkë.
18. Në krye të bashkisë.
20. Eshhtë kundërshtar në dashuri
23. Meta në krye të LSI.
24. I vidhet ushtai.
27. Jeppet e Artë në Cannes.
28. Eshhtë pije e jona.
29. Kufizojnë kënde.
31. Fillojnë lehtë.
33. Eshhtë dritëshkurtri.
35. Eshhtë numri i... të parit.
38. Fillojnë nazet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

6	9		3					8
	1		5	2				
		7				6	3	1
		5	2	6		1	9	
	3		9		4		7	
	4	2		5	1	8		
4	5	3				7		
				7	8		1	
8				5		2	9	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	5	8	4	1	6	3	9	7
6	4	9	7	5	3	2	8	1
7	3	1	9	8	2	6	4	5
5	1	2	3	6	9	4	7	8
9	8	3	5	4	7	1	2	6
4	7	6	8	2	1	9	5	3
3	6	4	2	7	8	5	1	9
1	2	7	6	9	5	8	3	4
8	9	5	1	3	4	7	6	2

Argëtim filozofik

- Stili është një mënyrë e thjeshtë për të thënë gjëra të komplikuar. (Zhan Kikto)
- Cdo njeri është gjeni të paktën një herë në vit, një gjeni i vërtetë ka ide origjinale gjithnjë të pranishme. (G.C.Lihtenberg)
- Pranoheni vendin që ka caktuar për ju i plotfuqishmi, shoqëria e bashkëkohësve tuaj dhe lidhja midis ngjarjeve. (Ralf Valdo Emerson)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	8	4	2	4		13	1		13	
18	3	1	4		18		3	17	13	1	
8	1	10		10	1	3	1	6	8		
6		1	10	2	3	6	14	1	12	2	4
	13	3	5	4	2	8	4	1	12	4	2
15	9	6	15	1	12	4	6		6	3	18
17	2	4	5	12		2	14		17	5	3
	8	1	7	6		3	1	10	1		
4	5	12			4	6	4	18	7	7	6
1	A	R	E	S		1	5			2	3
13	19		1	3		20	5	4	6	10	6
1	1		10	2	3	2	12	15	18	2	8

R	O	M	A	N	C	I	E	R	E	T	C	
I	R	O	N	L	T	R	U	P				
T	R	T	A	R	T	A	R	E	T			
K	A	M	E	R	I	E	R	E	T		U	
D	E	L	I	R	A	N	T	E	T		P	R
C		T	A	B	O	R		A	T	A		
K	R	I	P	E		A		O	L	E		
S	L	O	I	L	P		R	A	U	L		
T	A	N	T	A	L	I		U	R	R	A	
U	S	R		E	K	I	P	I		T	E	
F	A	T	A	L		A	L	I	E	N	E	T
E	T	A	P	A	T		K	A	T	E	T	I

Thënie të mënçura

- Mireqenia krijon miq - fatkeqesite i vene ne prove. Pubilius Syrus (~100 BC)
- Miqte mund te vijne dhe te ikin - por armiqte grumbullohen gjithnje e me shume. Thomas Jones (1892 - 1969)
- Nga mënyra e të qeshurit unë kuptoj se çfarë edukate ka një njeri, ndërsa nga arsyeja e të qeshurit kuptoj inteligjencën e tij. Rumiu
- "Testi i vërtetë i karakterit nuk është se sa ne dimë dhe se si ta bëjmë, por se si ne sillmë kur kur dimë se çfarë të bëjmë." John Holt

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	T	M	L	T	R	A	J	T	A	T		
P	L	K	A	P	A	L	I	E	N	E		
R	E	K	O	R	D	E	T	P	M	T	R	
I	A	N	S	A	M	B	L	I	H	E	M	
M	A	R	T	I	N	E	D	E	N	I	N	E
O	H	A	R	A	T	T	I	T	R	A	T	
B	A	N	A	P	I	S	H	E	I			
E	P	T	E	T	E	T	T	E	S	T		
M	I	N	A	T	N	A	I	T	I	M	A	
I	K	A	A	K	R	I	M	A	R	T		
L	A	P	A	R	A	R	O	J	A			
E	T	I	K	A	S	E	N	A	T	O	R	I

FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

